



Tempus

**PhD@UP**

# Krijimi i kapaciteteve për reformimin e programeve të doktoraturës në Universitetin e Prishtinës

Raport - Analizë - Rekomandime

# Përmbajtja

Hyrje.....	4
Metodologjia dhe terminologjia.....	8
Si ta lexojmë këtë raport? .....	8
Procesi i Bolonjës .....	9
Terminologjia e përdorur.....	10
Projekti .....	11
Qëllimet e projektit.....	11
Partnerët .....	11
Përmbledhje e projektit .....	13
Universiteti i Gracit.....	14
Profili universitar .....	14
Profili kërkimor .....	15
Studimet e doktoratës .....	.....
Universiteti i Grënadës .....	19
Profili i Universitetit .....	19
Profili i hulumtimit .....	20
Shkollimi Doktorat .....	21
Universiteti i Vassas .....	25
Profili universitar .....	14
Profili kërkimor .....	15
Studimet e doktoratës .....	.....
Universiteti i Prishtinës .....	31
Profili universitar .....	31
Profili kërkimor .....	32
Studimet e doktoratës .....	33
Programi i doktoraturës “Shkencat e ushqimit dhe teknologjia” në Universitetin e Prishtinës .....	36
(1) Programi.....	36
Struktura, zhvillimi dhe zbatimi .....	36
Aplikimi dhe procedurat e përzgjedhjes .....	37
Studentët .....	37
Financimi .....	38
Ndërkombëtarizimi .....	38
“Përbërësit që e bëjnë të suksesshëm një projekt pilot” .....	38
(2) Përvojat nga procesi i zhvillimit dhe zbatimit .....	39
Situata aktuale .....	39
Rezultate dhe përfundimet .....	41
Hulumtimi kombëtar / Strategjia e arsimit .....	41
Strategjia e universitetit .....	42
Zbatimi i programeve të doktoraturës .....	46
Rekomandimet dhe si t'i zbatojmë ato në praktikë .....	48
Autorët .....	52
Referencat dhe ueb faqet .....	56



Tempus

## Impressum

Ky projekt u financua nga Komisioni Europian. Ky publikim paraqet vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mban përgjegjësi për asnjë lloj përdorimi të mundshëm të informacioneve që përmban kjo broshurë.

Ky publikim u hartua mbi bazën e kontributeve nga partnerët pjesëmarrës në këtë projekt dhe u redaktua nga Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare e Universitetit të Gracit, Austri.

Fotot janë siguruar nga autorët, Universiteti i Gracit, Lunghammer, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Granadës, Universiteti i Vaasa, WUS- Austria

Faqesja: Simone Lindner

Redaktorë: Ulrike Krawagna, Anja Hoffmann, Universiteti i Gracit, Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Botuar nga: Dorrong OG, Grac, Austri 2014

# Hyrje

## Universiteti i Gracit

Universiteti i Gracit ka një traditë të gjatë të bashkëpunimit me Europën Jug-lindore, e cila në vitin 2000 u theksua dukshëm, pasi që Univeristet i Gracit zgjeroni fokusin e tij në pothuajse të gjitha rajonet e Europës Juglindore. Duke qenë universiteti i parë nga zona e vendeve gjermano-folëse, që ndërmoi një hap të tillë dhe për arsye të njohurive të thella mbi potencialin dhe nevojat e partnerëve nga ky rajon, Universiteti i Gracit luan edhe rol të rëndësishëm në koordinimin e shumë projekteve të ndryshme trans-nacionale.

Synimi kryesor i projektit të TEMPUS i titulluar “Programi i doktoraturës në shkencë të ushqimit dhe teknologjinë dhe krijimi i kapaciteteve për reformën e programeve të doktoraturës në Universitetin e Prishtinës - PhD@UP” është të kontribuojë në krijimin/ngritjen e kapaciteteve dhe reformimin e kurikulave në Universitetin e Prishtinës. Kjo do të thotë se në një anë Universiteti i Gracit jep mbështetje në cilësinë e një institucioni koordinues, por nga ana tjetër të gjitha institucionet e përfshira mësojnë në mënyrë reciproke për realitete të ndryshme në mënyrë që t'i përmbushin nevojat e të gjithëve. Për aq kohë sa zgjati projekti, partnerët arritën që të zbatojnë me sukses këtë program ndërdisiplinor të doktoraturës në “Shkencë ushqimore dhe teknologji” ku përfshihen tri fakultete të Universitetit të Prishtinës. Për më tepër, aktivitetet e ndryshme siguruan një shkëmbim jetik të nevojave dhe njohurive mes kolegësh nga institucionet partnere të BE-së dhe të Universitetit të Prishtinës.

Universiteti i Grazit e konsideron veten si institucion ndërkombëtar, i përkushtuar ndaj kërkimit shkencor dhe mësimdhënies

në dobi të shoqërisë. Politika jonë synon ruajtjen e lirisë në fushën e kërkimeve shkencore dhe mësimdhënies, kjo na bën të përkushtuar në mënyrë të vazhdueshme ndaj zhvillimeve shoqërore, politike dhe teknologjike. Krahas ambicies për të ndërtuar profil dhe vizibilitet si në kontekstin Europian ashtu edhe atë global, karakteristikë tjetër që na veçon është fakti që Universiteti ynë ka fituar një pozitë të veçantë në rajonin e Europës Jug-lindore. Prandaj, kemi një knaqësi të veçantë për kontributin e dhënë në këtë projekt, jo vetëm si grant-mbajtës por edhe si udhërrëfyes i dy pakove të punës që kanë çuar te ky raport i tanishëm. Bashkëpunimi afatgjatë në mes të Universitetit të Gracit dhe atij të Prishtinës përbënin bazën kryesore për fillimin e këtij projekti shumë sfidues.

Ky publikim krahas përshkrimit dhe analizës së sistemeve të ndryshme të zbatimit dhe të organizimit të studimeve të doktoraturës, vë në dukje të arriturat e konsorciumit të projektit, gjithashtu paraqet një instrument të mundshëm për veprime të mëturjeshme në Universitetin e Prishtinës. Bashkëpunimi i ngushtë që i ka kontribuar ndjeshëm suksesit të këtij projekti do të mbahet në mend për të mirë.

Prof. Dr. Christa Neuper  
Rektore e Universitetit të Gracit



# Hyrje

## Universiteti i Prishtinës

Universiteti i Prishtinës (UP) është institucioni i parë publik i arsimit të lartë në Kosovë, i themeluar në vitin 1970. Ky institucion i arsimit të lartë ka 16 fakultete, rreth 1.500 mësimdhënës, rreth 379 personel administrative dhe rreth 54.000 studentë të rregullt dhe me korrespondencë. Universiteti i Prishtinës është anëtar i plotë në Shoqatën e Universiteteve Europiane. Meqenëse Kosova ka popullsinë më të re në Europë, edhe për një kohë do të jetë tejet e vështirë që tregu i punës të arrijë të absorbojë numrin e gjithë këtyre të rinjve që futen në tregun e punës për çdo vit. Me qëllim që kjo të bëhet e mundshme, Kosova duhet të nisë reformat në disa fusha të ndryshme, dhe posaqërisht të ofroj shkollim në fushat më prioritet (prodhimin e ushqimit, burimet natyrore, minierat etj) dhe të identifikojë mundësitë dhe përparësitë e veta konkurruese. Për të arritur këtë synim, UP ka marrëveshje bashkëpunimi me një numër të madh të institucioneve akademike dhe kërkimore-shkencore nga vende të tjera të rajonit, nga Europa dhe më gjerë, që kanë siguruar mundësi të llojllojshme të mobiliteteve për studentët në nivelin e studimeve Master apo Doktoraturë. Që nga viti 2001, UP po bën përpjekje të mëdha për të zhvilluar dhe zbatuar parimet e Deklaratës së Bolonjës. Në këtë linjë, shumë njësi akademike (fakultete) organizojnë studimet mbi bazën e sistemit 3+2+3, ku praktikohet Sistemi Europian i Transferimit të Kredive (ECTS).

Në këtë pikëpamje, UP së bashku me partnerët (Universitetin Teknik të Mynih-ut – Gjermani (TUM), Universiteti i Granadës – Spanjë (UG), Universiteti i Gracit – Austri (KFU), World University Service - Austrian Committee (WUS Austria), Universiteti i

Vaasa-s- Finlane (UOV), dhe Austrian Exchange Service (OeAD)) është duke implementuar programin e studimeve të doktoraturës në “Shkencë dhe teknologji uqimore”, ku përveç tjerash promovohet: bashkëpunimi akademik ndërkombëtarë, konsultimi i ngushtë dhe përfshirja e studentëve, sigurimi i konsistencës dhe cilësisë përmes partneritetit dhe bashkëpunimit mes tyre, shkëmbimi i dijeve dhe vlerësimi nga kolegët, procesi i ndërkombëtarizimit të kërkimeve shkencore dhe mësimdhënies, qasja ndërdisiplinore që është në linjë me prioritetet strategjike të TEMPUS, me Strategjinë për zhvillimin e Kosovës, me Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit të Lartë (në Kuadrin e Planit Strategjik të Arsimit Kosovar 2011-2016) dhe me Strategjinë Zhvillimore të UP-së si dhe të prioritetëve aktuale të BE-së.

Është e qartë pra që një qasje si kjo e projektit paraqet mbështetje për sektorin e kërkimit shkencor, politikave që mbështesin agrikulturën, zhvillimin ekonomik, aspektet e shëndetit dhe të ambientit, konceptet e integritit Europian sikur që edhe e inkurajon dhe e krijon një mekanizëm për zhvillimin e studimeve të doktoraturës në Universitetin e Prishtinës, sipas sistemit të Bolonjës.

Me nderime,  
Ibrahim GASHI,  
Rektor i Universitetit të Prishtinës



# Hyrje

## Aktivitetet e WUS Austria në Kosovë

Shërbimi Universitar Botëror (World University Service) - (WUS) Austria është një organizatë jo-qeveritare politikisht e pavarur, e përkushtuar ndaj promovimit të së drejtës njerëzore për arsimim mbi bazën e lirisë akademike dhe të autonomisë së universitetit. Që nga themelimi i saj me 1983, në Grac, WUS Austria ka punuar në gjithë botën. Sot ka një fokus rajonal në Europën Juglindore dhe në atë Lindore dhe disponon me dy zyra një për degën në Sarajevë dhe tjetra për degën në Prishtinë. Rajonet e tjera si Afrika, Karaibet dhe shtetet e Paqësorit, Afrika Veriore, Lindja e Mesme dhe Kaukazi janë gjithashtu në fokus të punës sonë. WUS Austria është anëtar i WUS Internacional, organizatë që bashkon komitetet të WUS-it të njohura ndërkombëtarisht që vijnë nga e gjithë bota.

Që nga viti 1997 WUS Austria është prezent në Kosovë dhe që atëherë ka mbështetur Universitetin e Prishtinës përfshirë kohën e konfliktit më 1999 po edhe më vonë. Që nga ajo kohë, kemi punuar edhe me universitetet e formuara rishtazi në Kosovë, si ato publike ashtu edhe ato private. WUS Austria, është krenare që është partnere me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) së Kosovës, për masat e ngritjes së kapaciteteve, për mbështetjen e zyrës Qendrën Kombëtare për Nohje dhe Informim Akademik NA-RIC si dhe për mundësinë që të japë kontribut për fuqizimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA) në cilësinë e aktorit thelbësor në procesin e sigurimit të cilësisë në sektorin e arsimit të lartë. WUS Austria ka zhvilluar aktivitetet e saj në Kosovë gjatë shumë viteve në mënyrë që t'ju përgjigjet nevojave vendore. Në dekadën e parë të vitit 2000 ajo siguroi një mbështetje të gjerë për zhvillimin e sektorit të arsimit të lartë, sidomos për UP, përmes fondeve Austriake për zhvillim dhe bashkëpunim (Austrian Development Cooperation - ADC). Këtu përfshihet zhvillimi i lëndëve të reja dhe modifikimi i disa prej lëndëve ekzistuese të studimeve universitare dhe të programeve Master. Për të mbushur mungesat e kapaciteteve për kërkim shkencor dhe mësimdhënie u ftuan studiues të ndryshëm që kishin emigruar nga Kosova dhe punonin si mësimdhënës jashtë vendit, kështu u dha ndihmë për 'kthimin e trurit'. Gara mes studentësh për çështje të studimeve, ku përfshihen trajnime dhe panairë pune, u

krijuan mundësi për studentë që të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të hyjnë në kontakt të drejtpërdrejtë me punëdhënësit vendorë dhe ndërkombëtarë. Në bashkëpunim me BE dhe partnerët rajonal, WUS Austria kontribuoi për zhvillimin e strukturës dhe infrastrukturës së UP (Zyra për Zhvillimi Akademik, R&D dhe Qendrat e Observimit të Kompetencave). Kemi themeluar struktura për sigurim të cilësisë (Quality Assurance - QA) dhe kemi iniciuar kulturën e cilësisë dhe punës cilësore në UP si dhe në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Kosovë. Jemi akoma të pranishëm në Kosovë dhe gjithnjë bashkëpunojmë me institucione të arsimit të lartë si dhe me palë të tjera të interesuara. Projekti ynë më i madh aktual i financuar nga ADC është: "Higher KOS- Promovimi i Zhvillimit Institucional në Arsimin e Lartë dhe Kërkimet Shkencore në Kosovë". WUS Austria ndihet krenare që është koordinatore e projektit të TEMPUS PhD@UP. Projekt i cili nëpërmjet angazhimit të përbashkët të të gjithë partnerëve, veçanërisht të Universitetit të Prishtinës, i ka përbushur me sukses dy objektivat kryesore të tij: (1) është formuar dhe zbatuar një program i ri i doktoraturës në Shkencën dhe Teknologjinë e Ushqimit, nga profesorë të UP dhe nga profesorë të institucioneve partnerë nga BE, me çrastë janë mundësuar edhe mobilitetetet ndërkombëtare të studentëve dhe (2) janë iniciuar modele të ndryshme studimesh të doktoraturës dhe janë hartuar një sërë rekomandimesh për përmirësimin e strukturës së studimeve të doktoraturës në UP. WUS Austria ndjehet krenare për kontributin që ka dhënë për zhvillimin e shoqërisë Kosovare. Kemi kënaqësinë që të vazhdojmë punën dhe përpjekjet tona në Kosovë me qëllim që të krijojmë një shoqëri të bazuar në dije ku universitetet kanë një rol të rëndësishëm dhe janë promotorë të inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Almir Kovačević  
Drejtor Ekzekutiv, WUS Austria



# Metodologjia dhe terminologjia

## Si ta lexojmë këtë raport ?

Para së gjithash, qëllimi i këtij raporti referues është të paraqesë një përmbledhje të veprimeve, arritjeve kryesore, konkluzioneve dhe të rekomandimeve të projektit të TEMPUS “Doktoratura në Shkencën dhe Teknologjinë e Ushqimit dhe krijimi i kapaciteteve për reforma në studimet e doktoraturës në Universitetin e Prishtinës –PhD@UP”.


Raporti është elaboruar në kuadrin e kontekstit Europian si edhe në kuadrin e kontekstit të projektit duke u fokusuar në metodologjinë dhe terminologjinë e përdorur.

Pjesa e parë prezanton kontekstin e projektit duke e përfshirë të gjithë projektin, mënyrën e realizimit dhe metodologjinë e përdorur.

Pjesa e dytë fokusohet në kontekstin Europian dhe pikat e referencës të përcaktuara nga universitetet partnere europiane. Në këtë pjesë bëhet krahasimi i dallimeve dhe strukturave me fokus në ciklin e tretë të arsimit të universiteteve partnere. Përveç kësaj, këtu jepet një pamje e përgjithshme e situatës aktuale në planin e kërkimit shkencor dhe të studimeve të doktoraturës në universitetet partnere të sipër përmendura.


Pjesa e tretë paraqet rezultatin kryesor të projektit: krijimin e programit të ri të studimeve të doktoraturës në “shkencën dhe teknologjinë ushqimore”, në Universitetin e Prishtinës, sipas sistemit të Bolonjës. Ky program studimesh të doktoraturës jo vetëm se do

të shërbejë si praktika më e mirë e këtij raporti referues por edhe do të ofrojë propozime për përmirësimin dhe qëndrueshmërinë e programeve të doktoraturave që ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.



Kjo pjesë e përshkruan përmbajtjen dhe strukturën e programit të doktoraturës duke përfshirë kriteret e pranimit dhe procesin e përzgjedhjes së studentëve. Përveç kësaj, kjo pjesë jep një pasqyrë të përgjithshme të bashkëpunimit mes partnerëve të përfshirë në projekt duke u fokusuar në aspektet e ndër-kombëtarizimit, në çështje të financimit si dhe në personelin e përfshirë në program. Për më tepër, paraqet zhvillimin dhe zbatimin e programit të doktoraturës duke reflektuar mbi aspektet negative dhe ato pozitive. Pjesa e tretë e raportit mbyllet me një përmbledhje të situatës së tanishme të këtij programi të doktoraturës.

Pjesa e katërt jep përmbledhjen e analizave, të përfundimeve të nxjerra nga projekti si dhe jep rekomandimet për përmirësime të tjera në të ardhmen, në nivel të studimeve të doktoraturës në Universitetin e Prishtinës dhe në Kosovë, duke i paraqitur rezultatet, gjetjet si dhe arritjet që kanë dalë gjatë rrjedhës e projektit. Për më tepër, kjo pjesë vë theksin te tendencat aktuale europiane për ciklin e tretë të arsimit, që del si pjesë e përfundimeve plotësohet me këshilla praktike dhe me shembuj nga përvojat universitare për rekomandimet e dhëna. Nga këto rekomandime mund të përfitojë jo vetëm Universiteti i Prishtinës



por dhe çdo universitet tjetër kosovar që e ka të drejtën për të organizuar studime të doktoraturës.

## Procesi i Bolonjës

Para se ta listojmë terminologjinë e përdorur në këtë raport, është me rëndësi që të shpjegojmë se çka kuptojmë me shprehjen: “të jetë në linjë me sistemin e Bolonjës”, në mënyrë që të kuptojmë kapitujt në vazhdim si dhe raporti në tërësi:

Procesi i Bolonjës është hartuar të paraqesë, një sistem të gradave akademike që janë të dallueshme dhe të krahasueshme me lehtësi, të promovojë lëvizshmërinë (mobilitetin) e studentëve, mësimdhënësve dhe hulumtuesve, të sigurojë mësimdhënien të cilësisë së lartë si dhe të inkorporojë dimensionin europian në arsimin e lartë.

Deklarata e Bolonjës përfshin gjashtë veprime që lidhen me:

1. Një sistem gradimit akademik që mund të dallohen dhe krahasohen me lehtësi. Kjo përfshinë edhe zbatimin e përbashkët të suplementit të diplomës për të përmirësuar transparencën.
2. Një sistem, që në thelb bazohet në dy cikle: cikli i parë që zgjat tri vite dhe është i përshtatur për tregun e punës dhe cikli i dytë (Master) i kushtëzuar me përfundimin e ciklit të parë.
3. Një sistem të grumbullimit dhe transferimit të kredive të tipit ECTS që përdoret nga skema e shkëmbimit të Erasmus.
4. Lëvizshmëria e studentëve, mësimdhënësve dhe hulumtuesve: heqja e të gjitha pengesave të lirisë së lëvizjes.
5. Bashkëpunimi që lidhet me sigurimin e cilësisë
6. Dimensioin europian në arsimin e lartë: rritja e numrit të moduleve në fusha të mësimdhënies dhe të studimit ku përmbajtja, udhëzimet apo organizimi e kanë dimensionin europian.

## Terminologjia e përdorur

### Doktoranti

Doktorant është studenti i një programi të studimeve të doktoraturës.

### Universiteti i Gracit

#### Programi i doktoraturës

“[...] Programet e doktoraturës konsiderohen ato programe që bashkojnë nga 5 deri në 15 njësi akademike habilituese nga fushat e njëjta, të ngjashme apo nga fusha krejtësisht të ndryshme të specializimit të cilat organizojnë studime të cilësisë së lartë për një numër të limituar doktorantësh në kuadrin e këtyre fushave të studimeve, të cilët do të promovojnë shkëmbimin profesional.”<sup>2</sup>

### Kolegjet doktorale

“ kolegjet doktorate shërbejnë si hapësira ku doktorantët mund të punojnë në mënyrë specifike në një program të përbashkët të hulumtim/kërkimit shkencor, që në mënyrë të organizuar financohen nga palët e treta.”<sup>3</sup>

### Shkollat doktorale

“Shkollat e doktoratës janë zona me performancë të veçantë që mbikëqyrin dhe arsimojnë doktorantët gjatë studimeve të tyre.”<sup>4</sup>

### Universiteti i Grënadës

#### Programi i doktoraturës

“Programi i doktoraturës paraqet serinë e aktiviteteve së bashku me planin e hulumtimit shkencor që rezultojnë me përvetësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për ta marrë gradën shkencore të doktoratës. Qëllimi i programit është të zhvillojë aspekte të ndryshme të trajnimit të doktorantëve si dhe të përcaktojë procedurat dhe linjat e kërkimit shkencor të disertacioneve.”<sup>5</sup>

### Shkolla e doktoratës

“Shkolla e doktoratës është njësi e ngritur nga një apo më shumë universitete, me mundësi bashkëpunim edhe me organe të tjera siç janë qendrat, institucione apo entet aktive në R+D+i, qofshin ato kombëtare apo të huaja, qëllimi themelor i të cilave është organizimi dhe menaxhimi i studimeve të doktoratës.” Shkollat e doktoratës janë përgjegjëse për programet e doktora-

turës në tri fusha të studimit (shkencat dhe inxhinieria; shkencat e mjekësisë; shkencat shoqërore dhe humanitare).

### Universiteti i Vaasa së

#### Programi i doktoraturës

“Programet e doktoraturës janë përgjegjëse për zhvillimin sipas fushës së veçantë dhe për zbatimin e studimeve të doktoraturës.”

### Shkolla e Postdiplomimit

“Shkolla postdiplomike është përgjegjëse për zhvillimin e studimeve të doktoraturës si dhe për cilësinë e veprimtarisë dhe proceseve të studimeve të doktoraturës që fillon nga procesi i paraqitjes për studime e vazhdojnë deri te dhënia e gradës: Doktor Shkence. Shkolla e postdiplomimit organizon kurse të përgjithshme dhe fillestare që janë të njëjta për të gjithë studentët postdiplomikë.”<sup>7</sup>

### Universiteti i Prishtinës

#### Këshilli i Studimeve të Doktoraturës

Në nivel të njësisë akademike (fakultetit) = Këshilli i Studimeve të Doktoraturës së njësisë akademike përkatëse.

Në nivel të Universitetit = Këshilli Qendror i studimeve të doktoraturës.<sup>8</sup>

### Koordinatori i studimeve të doktoraturës

Koordinatori i studimeve të doktoraturës është anëtar i personelit që ka një gradë akademike të mësimdhënies, një gradë artistike të mësimdhënies apo një gradë akademike nga njësi përkatëse akademike në të cilën bëhen studimet.<sup>9</sup>

## Projekti

Projekti i përbashkët i TEMPUS “Programi i doktoraturës: shkencat të ushqimit dhe teknologjinë dhe krijimi i kapaciteteve për reformën e doktoratave në Universitetin e Prishtinës- PhD@UP” është hartuar si projekt ndërdisiplinor, sipas linjës së prioriteteve strategjike të TEMPUS-it, strategjisë së zhvillimit të Kosovës, strategjisë së zhvillimit të arsimit të lartë si dhe strategjisë zhvillimore të Universitetit të Prishtinës po ashtu edhe në linjë me prioritetet aktuale të Asociacionit të Universiteteve Europiane (EUA). Për këtë arsye ky projekt ka ardhur si iniciativë e drejtpërdrejtë e Universitetit të Prishtinës.

Projekti u përgatit në sajë të bashkëpunimit mes anëtarëve të konsorciumit sipas iniciativës së përfituesit dhe mbi bazën e përvojës së partnerëve.

### Qëllimet e projektit

Qëllimi i projektit ishte mbështetja e reformave kurrikulare dhe ngritja e kapaciteteve në Universitetin e Prishtinës (UP) me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencisë Kosovare të Akreditimit dhe Unionit të Studentëve. Projekti përbëhej nga **dy komponentë kryesore**:

Një nga këto komponentë ishte: të formohet, të akreditohet dhe të zbatohet një **program ndërdisiplinor doktorature në shkencat të ushqimit dhe teknologji**. Kjo objektivë përfshinte fuqizimin e kapaciteteve kërkimore shkencore, si dhe përmirësimin e ndërkombëtarizimit dhe mobilitetet në ciklin e tretë të arsimit.

Duke qenë program ndërdisiplinor, programi i doktoraturës në shkencën dhe teknologjinë ushqimore përfshinë disa fakultete të Universitetit të Prishtinës: Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakultetin e Shkencave Matematiko - Natyrore dhe Fakultetin e Mjekësisë. Qëllimi ishte që përmes këtij programi, të krijohet një model i praktikave të mira që demonstroi modelin e doktoraturës të bazuar në standard europiane të kurrikulës, kërkimit shkencor, ndërkombëtarizimit dhe sigurimit të cilësisë. Programi u akreditua nga Agjencia Kosovare e Akreditimit dhe u bë pjesë integrale e Universitetit të Prishtinës.

# PhD@UP

“PhD in Food Science and Technology & Creating Capacities for PhD Reform at the University of Prishtina

Komponenti i dytë synonte që strukturën dhe proceset aktuale të doktoraturës në Universitetin e Prishtinës t’i vendoste në linjë me Procesin e Bolonjës, me standardet europiane dhe me tendencat e tanishme në këtë fushë e kjo pastaj të ishte baza për reformimin e kurrikulës.

Parakushtet për nismën e këtij programi të doktoraturës u ekzaminuan dhe dokumentuan gjatë dy pakove të punës që u organizuan për këtë qëllim. Në mesin e masave që u ndërmorën për ngritjen e kapaciteteve ishin edhe organizimi i trajnimeve dhe vizitave në institucionet e partnerëve nga BE. Analizat e gjendjes së tanishme në Kosovë si dhe krahasimi i saj me sisteme dhe standarde në Bashkimin Europian duhet të sjellë adoptimin e strukturave dhe proceseve të nevojshme. Në mënyrë që të arrihet ndikim optimal dhe i qëndrueshëm, por edhe si një vlerë shtesë në kuadrin e projektit, do të shfrytëzohet mundësia për të përhapur rezultatet dhe ndikimin e këtij procesi në gjithë Universitetin si një tërësi.

Këto veprime paraqesin përpjekje të përbashkët për përmirësimin e ofertës në nivelin e doktoraturës në universitet dhe paraqesin një hap më afër drejt integritimit të Kosovës në Zonën Europiane të Arsimit të Lartë (EHEA)

### Partnerët



Përbërja e konsorciumit të projektit doli si një “rrjedhë” logjike e idesë së projektit që ishte iniciuar nga partnerët vendorë. Konsorciumin e përbëjnë pesë partnerë vendor dhe gjashtë partner nga BE. Universiteti i Prishtinës, si përfituesi kryesor, u përfshi në mënyrë intensive në të gjitha aktivitetet e projektit. Projekti u bazua mbi nevojën konkrete për të zhvilluar një program ndërdisiplinor doktrature, si bazë për reformat e mëtutjeshme të strukturës dhe proceseve të ciklit të tretë në Kosovë.

Dy institutet që kryesisht u përfshinë në komponentin e parë të projektit janë Universiteti Teknik i Munihut dhe Qendra e Shkencës dhe Teknologjisë Ushqimore nga ky universitet si dhe Universiteti i Grënadës dhe Instituti i të ushqyerit dhe teknologjisë ushqimore nga ky universitet..

Bazuar në bashkëpunimin tradicional me Universitetin e Prishtinës dhe ekspertizën e tyre në fushat e nevojshme, të dy këto institucionet kontribuan në hartimin e programit dhe në vlerësimin e kurseve (së bashku me kolegët nga UP). Përveç kësaj, ata organizuan trajnime dhe dërguan profesorë mysafir për bashkë-mësimdhënie gjatë ligjerimit. Për më tepër, ata ftuan profesorë nga UP-ja për vizita studimore dhe pranuan studentë të doktoraturës për vizita 1deri 3 mujore.

Pakot e punës nga komponenta e dytë, janë udhëhequr nga Universiteti i Gracit, universitet partner në këtë projekt. Austria, si dhe Universiteti i Gracit, ka një bashkëpunim afatgjatë me Universitetin e Prishtinës në fusha të ndryshme. Ky bashkëpunim afatgjatë

mes Universitetit të Gracit dhe Prishtinës si dhe përvojat e shumta të përbashkëta ishin bazë për fillimin e procesit shumë kompleks për modernizimin e strukturës për ciklin e tretë në Universitetin e Prishtinës. Universiteti i Vassas, Universiteti i Grënadës dhe Shërbimi Austriak i Shkëmbimit (OeAD) i kontribuan këtij komponenti duke ofruar ekspertizën e tyre me uorkshope, vizita studimore dhe analiza të raporteve.

Shkëmbimi i vazhdueshëm i përvojave, ekspertizës dhe informacionit mundësuan që të gjitha institucionet partnere të japin kontributin e tyre në të dy komponentët e projektit.

Shërbimi botëror i Universiteteve (WUS) Austria si koordinatori i projektit dhe udhëheqës i pakos së punës për kontrollin e cilësisë, kishin një rol të rëndësishëm në projekt. WUS Austria ka mbështetur reformat e arsimit të lartë në Kosovë për 15 vite me radhë. Rolin kryesor e kishte të ofronte instrumente, dije dhe mësimet e nxjerra me qëllim që të siguronte transferimin e dijes dhe teknologjisë, efikasitetin, cilësinë, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e projektit. I gjithë projekti u mbështet nga palët vendore si: Agjencia Kosovare e Akreditimit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe dy unionet studentore të vendit : Unioni i Pavarur i Studentëve në Universitetin e Prishtinës dhe Lista Reforma e Studentëve. Përfshirja e tyre në projekt ishte një faktor vendimtar për qëndrueshmërinë dhe institucionalizimin e rezultateve të projektit dhe të shpërndarjes së tyre. Ata ofruan kontributin e ekspertëve për këshillin drejtues të projektit, po në të njëjtën kohë kishin edhe përfitime të drejtpërdrejta nga masat që u ndërmorën për ngritjen/krijimin e kapaciteteve.

## Përmbledhje e projektit

### Formimi, akreditimi dhe zbatimi i programit ndërdisiplinor të doktoraturës “Shkenca ushqimore dhe teknologjia” në UP

Pikat kryesore

- Hartimi i kurrikulës sipas kërkesave të Bolonjës
- Blerja e pajisjeve të laboratorit për kërkim shkencor
- Akreditimi nga Agjencia Kosovare e Akreditimit
- Zbatimi: pranimi i 15 studentëve
- Ngritja e kapaciteteve për të gjithë stafin e përfshirë akademik me anë të dy trajnimeve kërkimore shkencore.

### Harmonizimi i strukturës dhe proceseve të doktoratës në institucionet e tanishme të UP-së me kërkesat e Bolonjës

Pikat kryesore

- Analizat e strukturës dhe proceseve të doktoraturës dhe pikave të referencës.
- Ngritja e kapaciteteve të stafit esencial të UP-së që është përgjegjës për zhvillimin akademik, përmes tri trajnimeve të hartuara sipas nevojës, me fokus në fushat e më poshtë shënuara:
  - Trajnimi 1: Bazat e kontekstit evropian, kornizat ligjore, krahimi i strukturave dhe principeve kombëtare.
  - Trajnimi 2: Gjendja institucionale, strukturat dhe procedurat (hartimi, procedurat e zbatimit dhe akreditimit, çështjet akademike dhe organizative, ndërkombëtarizimi)
  - Trajnimi 3: Punësueshmëria dhe këshillimi për karrierë
- Bërja e një analize dhe raporti të referencës duke përfshirë përfundimet dhe rekomandimet për modernizimin e strukturave dhe procedurave të programeve të doktoraturës. Forward recom-

- mendations to UP Management, Senate and KAA for adoption
- Paraqitja e rekomandimeve para drejtuesve të UP-së, Senatit dhe KAA për përvetësim:
  - Organizimi i një Konference publike në Prishtinë për të prezantuar rezultatet e projektit

## Kontrolli i cilësisë

### Kontrolli i cilësisë së projektit dhe i rezultateve të tij u sigurova në këto nivele:

- Sigurimi i cilësisë në zhvillimin e kurrikulës, syllabuseve, dhe në procesin e të mësimdhënies
- Kontrolli i cilësisë përmes akreditimit
- Cilësia e strukturave dhe procedurave të zhvilluar të doktoraturës e siguruar përmes miratimit të tyre nga drejtues të UP-së dhe nga Senati


## Qëndrueshmëria

### Qëndrueshmëria u sigurova përmes institucionalizimit të rezultateve kryesore të projektit:

- Integrimi i programit të ri të doktoraturës në kurikulën e Universitetit
- Pranimi zyrtar i “Rekomandimeve për reformat në ciklin e doktoraturës në UP”

## Shpërndarja

Masat e shpërndarjes paraqesin një pjesë përbërëse të të gjitha pakove të punës dhe aktiviteteve të projektit dhe ato bëhen nga ana e të gjitha mjeteve në dispozicion: materialeve të shtypura, webfaqes e projektit, shumëzimit (përmes trajnimeve) dhe më e rëndësishmja nga organizimi i një konference publike.



# Universiteti i Gracit



## Profili i Universitetit


Sipas ligjit publik Universiteti i Gracit është person juridik, gjithëpërfshirës që veten e konsideron institucion ndërkombëtar të arsimimit dhe të kërkimit shkencor, që është i përkushtuar ndaj kërkimit shkencor dhe mësimdhënies për të mirën e shoqërisë. Universiteti përbëhet nga shtatë njësi organizative, gjashtë fakultete dhe një departament të administratës dhe shërbimeve. Organet më të larta të Universitetit janë Këshilli i Universitetit, Rektori, Rektori dhe Senati. Ligji i Universitetit 2002 është baza ligjore e organizatës. Për më tepër, secili universitet me anë të instrumenteve statutare, mund të kalojë rregullat e kërkuara (Statutin) sipas kornizës së ligjeve dhe rregullave. Rektori, Këshilli i Universitetit dhe Senati janë organet qeverisëse të Universitetit. Universiteti i Grazit është universitet publik që kryesisht financohet nga shteti. Pjesë e politikave të Universitetit është ruajtja e lirisë në punën kërkimore dhe mësimdhënie. Kjo e bën të përhershëm përkushtimin e universitetit ndaj zhvillimeve shoqërore, politike dhe teknologjike. Rritja e fleksibilitetit dhe globalizimit janë kushtet thelbësore të kësaj kornize. Fakti që universiteti ka arritur një pozitë të veçantë në rajonin e Europës Jug-lindore është një nga karakteristikat më të veçanta krahas ambicies së këtij universiteti për të krijuar profil dhe vizibilitet në kontekstin europian dhe atë global. Huluntim-kërkimet bazë apo ato të aplikuara mbi bazën e themeleve të integritetit shkencor dhe etik e përbëjnë ekselencën e performancës së Universitetit **Universiteti nxit dhe ushqen shumëllojshmërinë tematike dhe**

**metodologjike në kuadër të një rrjeti ndërkombëtar bashkëpunimi. Profilin universitar e ndërton duke e përcaktuar fokusin e huluntim kërkimeve sipas çështjeve me relevancë shoqërore. Ato që inkurajohen më së shumti janë temat ndërdisiplinore të huluntimit që sjellin inovacion dhe që nxisin bashkëpunimin. Universiteti i përfshinë studentët në huluntim kërkim shkencor në kuadrin e një konteksti të mësimdhënies mbi bazën e huluntimeve. Universiteti bashkëpunon me universitete të shkëlqyera europiane dhe jo-europiane dhe merr pjesë në rrjete të rëndësishme. Ai ia ofron shoqërisë në mënyrë aktive dituritë dhe rezultatet e përfituara përmes huluntimeve. Në këtë Universitet, studentët trajnohen të bëhen autonomë dhe si të diplomuar me aftësi të mëdha teknike dhe sociale, të kenë mendim kritik dhe ndërdisiplinor. Mësimdhënia ka të njëjtën vlerë me huluntimin dhe zhvillohet sipas standardeve të cilësisë së lartë. Mësimi i bazuar në huluntim merr parasysh nevojat e studentëve dhe kërkesat e shkencës, të shoqërisë dhe biznesit. Mësimdhënia inovative dhe ndërdisiplinore luan një rol po aq të rëndësishëm sa edhe shërbimi studentor për këshill-dhënie dhe arsimimi gjithëpërfshirës i tyre. Universiteti pranon se studentët janë ata që duhet të marrin përgjegjësi për proceset e tyre të mësim nxënies dhe e përkrahë principin e pjesëmarrjes aktive, të tyre, në zhvillimin e mëtutjeshëm të mësimdhënies. E inkurajon mobilitetin e studentëve duke ofruar mobilitete ndërkombëtare dhe programe të përbashkëta të studimit.**

## Profili huluntues

Anët e forta të Universitetit shtrihen nëpër fakultete në zonat esenciale të huluntimit akademik. Në këtë mënyrë forcohet bashkëpunimi i ngushtë, sidomos në fushat e shkencave humane, shoqërore dhe kulturore. Universiteti i Gracit angazhohet për të koncentruar, fokuset ekzistuese relevante për shoqërinë në nivel fakulteti, në zonat esenciale të huluntimit universitar. **Universiteti i Gracit për të zhvilluar potencialin e vet, ndjek strategjinë e bashkëpunimit me universitetet e rajonit dhe përdor efektet e energjisë së përbashkët, që rezultojnë nga koncentrimi i resurseve dhe aftësive. Me qëllim të arritjes së një mase kritike, objektivi i huluntimit është i drejtuar kah fushat e përbashkëta të huluntimit, veçanërisht me Universitetin Teknik të Gracit dhe Universitetin e Mjekësisë të Gracit. Bashkëpunimet e tanishme ndëruniversitare me NAWI dhe bashkëpunimi i ardhshëm me BIOTECHMED, për Gracin si qendër shkencore janë esenciale. Aspekt i rëndësishëm i këtij zhvillimi është harmonizimi i zonave esenciale të huluntimit me lokacionet e universiteteve pjesëmarrëse.**

Universiteti gjithashtu i ka identifikuar zonat esenciale të huluntimit: truri dhe sjellja, heterogjeniteti dhe kohezioni, historia kulturore dhe interpretimi i europës, mësimi-nxënja – arsimimi – dija, modelet dhe simulimet, enzimologjia molekulare dhe fiziologjia, ndryshimet e ambientit dhe ato globale. Financimi: Ekziston një shumëllojshmëri e mundësive të financimit jashtë buxhetit global të universitetit: FWF, OeNB, Programi i kornizës së huluntimit të BE-së etj. Universiteti gjithashtu ka disa bashkëpunime me partnerë jo-universitarë të huluntimit. Mbi 20 qendra të huluntimit janë të grumbulluara në universitetin e Gracit, përfshirë Laboratorin Christian Doppler dhe katër institute Ludwig Boltzmann. Bashkëpunime të tjera të huluntimit: NANONET-Styria = Rrjeti Styrian i nano-teknologjisë; GEN-AU = Huluntimi i gjenomit në Austri; GEN-AU = "GOLD – Gjenomika dhe çrregullimet e lidhura me lipidet "; Qendrat e kompetencës: Qendra austriake e bioteknologjisë industriale; Know-Center GmbH; Fondacioni Privat hapi tjetër evolaris; Qendra e Huluntimit Inxhinieria Farmaceutike GmbH.






## Studimet e doktoratës

*Arsimimi i hulumtuesve të rinj në fazën e tyre të hershme gjithnjë e më tepër duhet të zhvillohet brenda kornizës së programeve dhe shkollave të strukturuar të doktoraturës si dhe në kuadër të iniciativave për bashkëpunim ndërdisiplinor dhe ndërkombëtar.”<sup>10</sup>*

Studimet e doktoraturës në Universitetin e Gracit janë në linjë me Parimet e Salzburgut si dhe me skemën e Ciklit të Tretë sipas reformës së Bolonjës. Të gjitha programet zgjasin tre vite (kohëzgjatja minimale e studimeve) dhe përmbyllen me një disertacion, i cili duhet të jetë një kontribut origjinal në fushën e hulumtimit të cilës i përket. Më tutje, të gjitha programet e doktoraturës synojnë që doktorantëve t’ua mësojnë aftësitë kryesore të hulumtim-kërkimit që janë të domosdoshme për të mbijetuar në tregun akademik. Themelimi i shkollimit tre-vjeçar në nivel të doktoraturës nis në vitin 2007 (studimet e doktoraturës në shkencë natyrore). Studimet e doktoraturës në fakultetet tjera janë ristrukturuar sipas këtij plani në vitin 2009. Përveç kësaj, në Fakultetin Juridik u krijua edhe programi i përbashkët i doktoraturës „Qeverisja dhe Menaxhimi i Diversitetit“. Në tetor 2011 hynë në fuqi tri kurikulat e studimeve të doktoraturës: në Fakultetin e Shkencave të Ambientit ato Rajonale dhe Arsimore. Kësisoj, Universiteti i Gracit që (nga janari 2014) ofron studime të doktoraturës si në vijim: studime të doktoraturës në shkencat natyrore, në filozofi, në shkencë sociale dhe ekonomike, në teologji, në drejtësi, në fakultetin e shkencave të ambientit, ato rajonale dhe arsimore (filozofi, shkencë natyrore, program ndërdisiplinor të doktoraturës). Krahas studimeve të doktoraturës në formatin e rregullt tradicional Universiteti i Gracit ofron tri formate për arsimim të strukturuar të doktoraturës: Programet e Doktoraturës, Shkollat Doktorale dhe Kolegjet Doktorale. Që të tri këto forma të shkollimit ofrojnë një kualifikim të shkëlqyer për hulumtuesit në fazën e tyre të hershme. Programet e doktoraturës në Universitetin e Gracit janë të bazuara në hulumtim. Në secilin nga programet e doktoraturës që ofron Universiteti i Gracit, përfshihen në mënyrë aktive prej një deri të gjitha nga të gjashtë fakultetet.

Doktoratsstudierende und Doktoratsabschlüsse 2011/12



■ Anzahl der Doktoratsabschlüsse im Studienjahr 2011/12 (Stand 30.9.2012)  
 ■ Anzahl der gemeldeten Doktoratsstudierenden im Studienjahr 2011/12  
 Image 2 - Doctoral Students and Graduates per Area of Studies

Organizimi dhe zbatimi i një programi të doktoraturës përcaktohet me kurikulë. Ekziston një procedurë standarde për zbatimin e kurikulave të reja: komisioni i kurikulës (i përbërë nga profesorë dhe studentë) punon në kurikulën e re në bashkëpunim të vazhdueshëm me Prorektorin për Çështje Mësimore (d.m.th. me ekipin e tij për zhvillim të kurikulës) dhe me ekspertë të tjerë (p.sh. shërbimet për doktoraturës). Komisioni e bazon strukturën e kurikulës që do të zhvillohet mbi ndonjë kurikulë ekzistuese të Universitetit të Gracit. Versioni final i kurikulës së re hartohet gjatë një procesi të gjatë dhe intensiv dhe ky draft dërgohet në Senatën e Universitetit. Pastaj ky draft shqyrtohet nga një grup ekspertësh, i cili grup harton një raport i cili përfshin rekomandime etj. që i bëhen komisionit të kurikulës. Vetëm pasi të jenë hequr të gjitha pjesët problematike, kurikula diskutohet dhe miratohet nga Senati (para pushimeve verore) dhe hyn në fuqi më 1 tetor të vitit të ardhshëm akademik. Përveç aspekteve të tjera, kurikula rregullon edhe formatin e disertacionit. Disertacioni kryesisht paraqitet si një monografi e punës hulumtuese. Megjithatë, disa studime të doktoraturës e lejojnë mundësinë që kandidatët të shkruajnë një disertacion që mbështetet në shkrime të tjera. Ndërsa për sa i përket procesit të vlerësimit dhe ekzaminimit, disa kurikula kërkojnë vetëm mbrojtjen e disertacionit e disa të tjera kërkojnë mbrojtjen plus provimin me gojë (që kap çështje më të gjëra të fushës së hulumtimit). Zakonisht, komisioni i vlerësimit përbëhet nga një kryetar dhe dy vlerësues. Kryetarët mund të jenë njëkohësisht edhe vlerësues edhe kryetar, por kjo nuk është e domosdoshme. Disa kurikula sugjerojnë që vlerësuesit të jenë të jashtëm (d.m.th. që nuk punojnë në Universitetin e Gracit).

Universiteti i Gracit ka disa njësi administrative që merren me çështje të studimeve të doktoraturës, si: Zyra e Pranimit dhe Ekzaminimit dhe Zyrat e Dekanit (secili fakultet ka nga një zyrë të tillë), Drejtori i studimeve me ekspertët e tij/saj të Ligjit të Universitetit, Dekanët për Studime, kryetarët e komisionit të kurikulave, etj. Stafit akademik: marrëdhënia mentor-student tashmë është lënë anash në favor të një qasjeje me bazë ekipore. Arsimimi i strukturuar në nivel doktorature duhet gjithashtu të ofrojë një grup hulumtuesish që i ndihmojnë secilit doktorant. Disa kurikula e bëjnë edhe dallimin midis mbikëqyrësit dhe mentorit; mentorin nuk përfshihet në ekzaminimin e kandidatit, por vetëm i ofron ndihmë apo shërben si ndërmjetësues (në rast se ka ndonjë problem bie fjala me mbikëqyrësin). *“Kolegjet doktorale janë vendet që shërbejnë si hapësirë ku doktorantët mund të punojnë në një program të veçantë hulumtimi që financohet nga palët e treta në një mënyrë të organizuar.”<sup>11</sup>* Zakonisht kolegjet doktorale financohen nga Fondi Austriak për Shkencë (FWF). Financimi kryesisht mbulon pagat e doktorantëve po nuk financon infrastrukturën (zyrat, kompjuterët etj.). Gjatë studimeve të tyre doktorantët mund të kërkojnë grante të ndryshme.



Foto 3 Grantet që studentët kanë mundësi t'i kërkojnë.

Mesatarisht, nga Universiteti i Gracit, për çdo vit, dalin 200 të doktoruar dhe ata zakonisht e fillojnë një punë në fushat si në vijim:



Foto 4. Sektorët e punësueshmërisë ku zakonisht nisin punën e tyre Doktorët e Shkencës pas diplomimit

Tabela më poshtë tregon numrin e të doktorantëve të punësuar nga: Universiteti i Gracit më 31 dhjetor 2012 (burimi: LQM [Leistungs- und Qualitätsmanagement] Universiteti i Grazit):

Kategoria	Austria			BE		
	F	M	Totali	F	M	Totali
Punonjësit shkencor të financuar nga palët e treta	75	85	160	6	6	12
Punonjësit tjerë shkencor	123	86	209	9	4	13
Te tjerë	17	17	34	1	1	2
<b>Totali</b>	<b>215</b>	<b>188</b>	<b>403</b>	<b>16</b>	<b>11</b>	<b>27</b>

Kategoria	Vendet e treta			Totali		
	F	M	Totali	F	M	Totali
Punonjësit shkencor të financuar nga palët e treta	6	4	10	87	95	182
Punonjësit tjerë shkencor	4	4	8	136	94	230
Të tjerë	0	0	0	18	18	36
<b>Totali</b>	<b>10</b>	<b>8</b>	<b>18</b>	<b>241</b>	<b>207</b>	<b>448</b>

Programet e doktoraturës dhe kurikulat e tyre në Universitetin e Gracit lidhen me shoqërinë, me ekonominë dhe me tregun e punës. Secila kurikulë përmban një seksion të profilit të kualifikimit të të diplomuarve dhe një tjetër të lidhjes mes aftësive që i ofron programi i studimit dhe kërkesave të tregut të punës. Universiteti i Gracit angazhon shumë bashkëpunim në nivel institucional, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Sipas një sondazhi të mbajtur në verën e vitit 2013, Universiteti i Gracit numëronte 115 bashkëpunime me institucione në Austri apo në vendet fqinje, ku përfshihen doktorantët. Këto bashkëpunime përfshijnë hulumtim-kërkimet, seminarët e përbashkëta, mbikëqyrje të përbashkët, vlerësim të përbashkët të temave etj. Ekzistojnë mundësi që grada e doktoraturës të merret edhe përmes marrëveshjes për bashkë-mentorim. Për më tepër, Universiteti i Gracit ka iniciuar projektin strategjik “Nachwuchsförderung” [“Promovimi i hulumtuesve në fazën e tyre të hershme”] i cili projekt në mënyrë të veçantë e përkrah dhe ndërkombëtarizon punën e hulumtuesve në fazën e tyre të hershme (vizita hulumtuese, vizitave studimore, konferenca etj.).



## Universiteti i Granadës

### Profili i Universitetit

Universiteti i Granadës, si institucion publik, ofron shkollim, hulumtim-kërkim, shërbime dhe promovon zhvillimin lokal. Ky Universitet, i themeluar më 1531, është një nga universitetet më të vjetra të Spanjës. Menaxhmenti i Universitetit funksionon përmes disa organeve kolegjiale, siç janë: Trupi pedagogjik dhe Këshilli drejtues, po edhe përmes organeve individuale, siç janë Rektori, Zyrat e Prorektorëve, Menaxhmenti dhe Sekretariati i Përgjithshëm. Universiteti i Granadës ofron 75 grada të ndryshme për 60.000 studentët e vet, e të gjitha këto në nivel të studimeve themelore dhe post-diplomike si dhe për 20.000 studentë të tjerë që bëjnë studime shtesë në 28 fakultet dhe shkollat e këtij universiteti. **Universiteti, përmes 14 instituteve dhe 3 qendrave të veta të hulumtimit, me 346 grupe hulumtimi që janë të lidhura me botën e biznesit, i përfshinë të gjitha fushat e hulumtimit.** Përveç kësaj, Universiteti i Granadës ka pesë kampuse në qytetin e Granadës, dhe dy kampuse të tjera në qytetet Ceuta dhe Melilla, në Afrikën Veriore. Politika e universitetit për përdorimin e ndërtesave me vlerë historike dhe kulturore e ka pasuruar trashëgiminë e tij, si dhe ka promovuar restaurimin dhe mirëmbajtjen e këtyre ndërtesave. Krahas insistimit për të vënë theksin mbi elementet më tradicionale, **Kampusi Ndërkombëtar i Ekselencës në BioTic që e lidh Universitetin me institucione dhe ndërmarrjet lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare demonstroi përkushtimin e thellë ndaj inovacionit duke promovuar bashkëpunimin me kompani të teknologjisë bio-shëndetësore dhe duke e favorizuar dije bio-mjekësore dhe**

**përkujdesje shëndetësore të cilësisë së lartë. Qendra e Instrumentimit Shkencor (CIC) ofron shërbime të ndryshme me qëllim të përkrahjes së hulumtimeve, duke u fokusuar në veçanti të lëndët eksperimentale.** Bashkëpunimi në projekte ndërkombëtare, si dhe kërkimi i resurseve dhe partnerëve, menaxhohet përmes **Zyrës për Projekte Ndërkombëtare (OPI).**

Për shumë vite me radhë, Universiteti i Granadës ka promovuar një aktivitet të rëndësishëm ndërkombëtar falë më tepër se 600 marrëveshjeve për mobilitete, të nënshkruara me institucione europiane të arsimit të lartë dhe mobiliteteve të programeve të ERASMUS. Universiteti gjithashtu ka marrëveshje për programe të mëdha shkëmbimi me universitetet nga Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Amerika Latine, Europa Qendrore dhe Lindore, Lindja e Mesme, shtetet mesdhetare, Australia, Oqeania dhe Azia. Në Universitetin e Granadës gjenden **28 qendra mësimi dhe 116 departamente,** një shkollë e studimeve post-diplomike, e cila i koordinon të **68 kurset Master dhe 29 programet e Doktoraturës,** sikur edhe **113 kurse të tjera shtesë.** Kurset verore organizohen nga Qendra Mesdhetare. Gjatë gjithë vitit, Qendra e gjuhëve moderne ofron kurse të metodologjisë për mësimdhënie të gjuhës spanjolle si dhe kurse për mësimin e gjuhëve të huaja, që janë të hapura për publikun e gjerë. Qendra për Mësimin Tërë Jetësor ofron kurse për studentët të pjekur në moshë, të cilëve nuk u kërkohen kualifikime paraprake akademike. Ndërsa Qendra e Mësimin Virtual ofron trajnime virtuale.

*Universiteti i Grënadës përkujdeset për të ardhmen e vet duke zhvilluar hulumtim të kualitetit të lartë.* Promovimi i linjave tradicionale të hulumtimit, ofrimi i përkrahjes së rëndësishme në fusha të tjera, të cilat megjithëse janë më pak të zhvilluara, mund të jenë me interes për një shoqëri në ndryshim dhe për mbajtjen e lidhjeve me kompani dhe institucione, janë kriteret të cilat e përforcojnë hulumtimin që zhvillohet në universitet. Këto ide janë dëshmuar të suksesshme, sepse kanë sjellë rritjen e fondeve të dedikuara për hulumtim si dhe kanë hapur perspektiva solide për të ardhmen, që më parë nuk kanë ekzistuar. Rritja e sektorit shkencor e bën të sigurt pozitën e Universiteti në mesin e universiteteve kryesore të Spanjës. Marrëdhëniet e shkëlqyera me kompanitë publike dhe private në gjithë vendin, përmes kontratave të hulumtimit dhe shërbimeve tjera, janë garant i të ardhmes.

Për më tepër, të gjitha fushat e hulumtim-kërkimit në Universitetin e Grënadës ndjekin të njëjtat parime të hulumtimit

1. Ekselencë për të gjitha programet e doktoraturës. Qëllimi është të ruhet thirrja e dhënë nga Agjencia Spanjolle e Akreditimit të Kualitetit (ANECA) për ekselencë në këto programe si dhe arritja e kësaj cilësie për programet e tjera.
2. Aftësi profesionale. Reforma e programeve të doktoraturës mes tjerash ka për qëllim të trajnojë doktorantë, horizonti profesional i të cilëve nuk shtrihet vetëm në nivel akademik por edhe në nivel institucional dhe të kompanisë të lidhur me hulumtim.
3. Marrëdhënie ndërdisiplinore. Njëra nga objektivat e reformës së programeve të doktoraturës dhe krijimit të shkollave të doktoraturës është inkurajimi i trajnimit ndërdisiplinor dhe promovimi i marrëdhënieve mes studentëve të fushave të ndryshme.

4. Ndërkombëtarizimi. Si hulumtimi ndërkombëtar ashtu edhe ai institucional janë të esenciale, prandaj një objektivë tjetër është rritja e numrit të bashkëpunimeve me programe të doktoraturave jashtë vendit dhe promovimi i mbikëqyrjes së tezës së disertacioneve me citime ndërkombëtare.
5. Themelimi i lidhjeve të qëndrueshme me organizata jashtë Universitetit. Objektivë tjetër është krijimi i një marrëdhënieje të qëndrueshme me kompani dhe institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Sa i përket financimit, Universiteti i Grënadës financohet nga Qeveria Kombëtare dhe Rajonale, si dhe nga programet ndërkombëtare. Përveç kësaj grupet e hulumtimit gjithashtu marrin fonde edhe sipas produktivitetit të tyre.

*Fushat kryesore të hulumtimit në Universitetin e Grënadës*

- Shkencat e Agrikulturës
- Arkitekturë, Planifikim Urban dhe Rajonal
- Art dhe Dizajn
- Studime Biznesi, Shkencat e Menaxhmenti
- Edukim, Trajnim i Mësimdhënësve
- Inxhinieri, Teknologji
- Gjeografi, Gjeologji
- Shkenca Humane
- Gjuhë dhe Shkenca filologjike
- Matematikë, Informatikë
- Shkenca mjekësore
- Shkenca natyrore
- Shkenca Shoqërore
- Shkenca të Komunikimi dhe Informacioni

*Escuela Internacional de Posgrado* është përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e të gjitha studimeve postdiplomike si dhe për studimet e doktoraturës. *Objektivat e saj janë: të ofrojë trajnime komplementare të natyrës praktike me qëllim të arritjes së gradës përkatëse; të promovojë arritjen e aftësive të specializuara profesionale për të hyrë në tregun e punës; të lejojë ritrajnimin profesional me qëllim të pasurimit të profilit profesional dhe përmirësimit të karrierës aktuale.*

Në Universitetin e Grënadës ka pasur një zvogëlim të numrit të programeve të doktoraturës nga më tepër se 100 sa ishin më 1999 në 29 më 2013. Sot, programet e doktoraturës janë grupuar në tri shkolla të doktoraturës: **Shkencat e Mjekësisë:** Bio-mjekësia, Biokimia dhe Biologjia molekulare; Farmacia, Mjekësia Klinike dhe Shëndeti Publik; Nutricioni dhe Shkenca e Ushqimi, Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti, Hulumtim Multidisiplinor dhe Inovacion në Proceset e Paaftësisë (Processes of Disability), Varësia dhe Fundi i jetës; **Shkencat Shoqërore, Drejtësia dhe Shkencat Humane:** Studimet Ekonomike dhe të Biznesit, Shkencat e Edukimit, Shkencat Juridike, Shkencat Shoqërore, Hulumtimi i Migracionit, Filozofia, Historia dhe Artet e Bukura; Gjuhët, Tekstet dhe Kontekstet; Studimet Femërore dhe Gjinore; Metodologjitë e Mësimdhënies/Mësim-nxënies dhe Zhvillimi i Institucioneve Arsimore; **Shkencat Natyrore, Teknologji dhe Inxhinieri:** Biologjia Fundamentale dhe e Sistemeve; Shkencat e Tokës; Dinamika e rrjedhës Biogjeokimike dhe zbatimi i saj, Statistika dhe matematika e aplikuar; Fizika dhe Shkencat e Hapësirës; Fizika dhe Matematika; Inxhinieri Ndërtimore; Kimi; Program i Doktoraturës në Teknologjinë e Komunikimit dhe Informimit; Inxhinieri Ndërtimore dhe Arkitekturë.

Të gjitha programet e doktoraturës janë të bazuara në hulumtim/kërkim shkencor. Në Universitetin e Grënadës, si stafi administrativ ashtu dhe ai akademik punojnë për programet e doktoraturës. Përgjegjës për dizajnin, përditësimin, cilësinë, koordinimin si dhe pranimin e kandidatëve janë Komiteti Akademik dhe Koordinatori. Të njëjtat janë gjithashtu përgjegjës për progresin e hulumtimit, të trajnimit si dhe për autorizimin e prezantimit të tezës nga ana e seci-

lit student të programit. Drejtorët e disertacionit janë përgjegjës për të gjithë orientimin e të gjithë punës dhe detyrave të hulumtimit të doktorantëve. Ndërsa tutorët kanë për detyrë të përkujdesen që trajnimet e studentëve të jenë adekuate me parimet e programit. Universiteti i Grënadës nuk merr fonde për programet e doktoraturave. Programet e reja të doktoraturave zhvillohen sipas iniciativës së stafit akademik, kjo sidomos për arsye të grupeve të hulumtimit shumë produktive, të partneriteteve me universitete tjera, si dhe të ekzistencës së një zone koherente të zhvillimit në raport me tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar të punës. Kur hartohet një program i ri i doktoraturës, rregullorja si hap të parë e parasheh paraqitjen e kërkesës për miratimin e programit nga Shkolla e Doktoraturës, më pastaj paraqitja e kërkesës për miratim nga ana Këshilli Drejtues të Universitetit dhe pastaj paraqitja e kërkesës për verifikimin e programit nga Agjencia Kombëtare e Akreditimit (ANECA).




Foto 5 – Doktorantët e regjistruar dhe të diplomuar në vit; Universiteti i Grënadës

Shumë programe krijojnë rrjete të bashkëpunimit. Nga ana tjetër ka një tendencë për të reduktuar programet duke ruajtur ato që janë më produktive ose që kanë më shumë ndikim, sipas konceptit të ekselencës, dhe sipas përcaktimit të prioritetit në bazë të granteve në dispozicion për doktorantë.

Organizimi dhe zbatimi i një programi të doktoraturës përcak-

tohet në “Programa Oficial de Doctorado” të secilit program të doktoraturës. Këtu përfshihen struktura e programit, kriteret dhe procedura e pranimit, linjat e mundshme të hulumtimit, informata për drejtorin dhe koordinatorët, si dhe për disertacionin e doktoratës dhe paraqitjen e saj. Disertacioni mund të paraqitet në formën e memorandumit apo në si një përmbledhje e artikujve të publikuar. Provimi përbëhet nga këto pjesë: paraqitja me gojë e disertacionit, ku doktoranti jep një përmbledhje të metodologjisë që ka përdorur, hulumtimin që ka bërë, si dhe rezultatet dhe konkludimet që ka nxjerrë, duke përmendur në mënyrë të veçantë kontributin e vet origjinal; komisioni vlerësues, i përbërë nga pesë anëtarë e vlerëson disertacionin; doktoranti i komenton dhe u përgjigjet vlerësimeve dhe pyetjeve të parashtruara nga komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit apo pasi të gjithë anëtarët ta kenë përfunduar vlerësimin e tezës; më pas, doktorë e shkencës që janë prezent në këtë ngjarje publike lejohen të bëjnë pyetje. Pasi të ketë përfunduar provimi dhe pasi anëtarët e komisionit të kenë shqyrtuar dhe debatuar për kualifikimin e disertacionit, Kryetari e informon kandidatin mbi vlerësimin e përgjithshëm që i bëhet disertacionit sipas termave: “e pranueshme” ose “e papranueshme”. Anëtarët e komisionit vlerësues me votë të fshehtë e përcaktojnë përshtatshmërinë ose papërshtatshmërinë e punimit, kandidati mund të arrijë notën “cum laude” që është nota më e lartë e vlerësimit, nëse në mënyrë unanime jepet vlerësimi pozitiv.

Strategjia e programeve të doktoraturës në Universitetin e Grënadës është që të mbulojnë një fushë të gjerë hulumtimi, më të gjerë se programi i diplomimit. Gjithashtu këto programe zhvillohen në nivele shumë-disiplinore dhe trans-disiplinore si dhe duhet të jenë të lidhur me palët e interesit. Përveç kësaj, Universiteti i Grënadës doktorëve të rinj të shkencës u ofron mundësinë që të kryejnë praktikën profesionale postdoktorale dhe njejnë iniciativa të ndryshme të përbashkëta.

Doktorantët kanë mundësi që të kërkojnë grante të ndryshme

gjatë studimeve të tyre të doktoraturës.



Foto 6 – Grantet të cilat mund t'i kërkojë një doktorant në Universitetin e Grënadës

Zakonisht një numër prej mesatarisht, rreth 500, doktorantësh të diplomuar në vit në Universitetin e Grënadës e fillojnë punën në fushat si në vijim:





Foto 7 – Sektorët e punësueshmërisë ku doktorantët e diplomuar e nisin punën; Universiteti i Grënadës

Statistikat e mëposhtme tregojnë numrin e stafit të punësuar, në Universitetin e Grënadës, për mësimdhënie apo për hulumtim (burimi: Memoria Académica 2012/2013, Universiteti i Grënadës):

Punonjësit e angazhuar për mësimdhënie dhe hulumtim	
Asistentë	7
Associate professor	382
Profesorë të Asociuar Shkenca shëndetësore	211
Profesorë Asistentë	152
Asistentë Ligjërues	190
Profesorë	320
Profesorë Emeritus	8
Ligjërues vizitorë	17
Kategori të tjera	109
<b>Totali</b>	<b>1396</b>





# Universiteti i Vassas

## Profili universtar

Universiteti i Vassas është një universitet autonom që qeveriset sipas ligjeve publike. Arsimon liderë të përgjegjshëm dhe ekspertë për detyra ndërkombëtare. Fushat e Universitetit janë Shkencat e Administrimit, Studimet e Biznesit, Gjuhët dhe Teknologjia e Komunikimit. Fushat strategjike të Universitetit janë Financat, Menaxhmenti, Energjia dhe Multilingualizmi. Këto fusha strategjike janë tema shumë-disiplinore të mësimdhënies dhe hulumtimit, që Universiteti i ka përzgjedhur dhe që iu kushton vëmendje e veçantë. *Hulumtimi i Universitetit është i lidhur ngushtë me kohën e tij dhe prodhon dije shkencore të cilësisë së lartë në çështjet që janë të dobishme për shoqërinë dhe botën e biznesit.*

Universiteti u përgjigjet kërkesave moderne duke i pajisur studentët e tij me aftësi për detyra ndërkombëtare dhe me kompetenca të biznesit. Anë e fortë e Universitetit është fryma e komunitetit, e cila promovon studime multidisiplinore dhe i përgatit të diplomuarit për detyra, në jetën profesionale, që kërkojnë përgjegjësi. *Universiteti i Vaasas shkollon ekspertë kompetentë për nevojat e së ardhmes.* Në Universiteti i Vassas mund të merren grada të nivelit Bachelor, Master ose të Doktoraturës. Studentët, gjithashtu mund të studiojnë në Universitetin e Hapur apo, nëse janë të punësuar, mund të kryejnë trajnime të mëtejshme duke

marrë kurse në Institutin Levón. Universiteti gjithashtu ofron disa programe Master tërësisht në gjuhën angleze.

Universiteti i Vassas punëson mbi 500 pjesëtarë të stafit dhe arsimon mbi 5.000 studentë në Bachelor dhe Master, ka edhe rreth 380 doktorantë.

Organi më i lartë vendimmarrës i Universitetit është Bordi i cili emërohet nga Kolegjiumi i Universitetit. Punët e Universitetit drejtohen nga Rektori, të cilin e zgjedh Bordi. Për kryerjen e detyrave të tij Rektori përkrahet nga Grupi Drejtues, të cilin e përbëjnë Dekanët dhe Rektori, i cili njëherazi është edhe kryetar i Grupit.

Universiteti numëron tri fakultete: Fakulteti i Filozofisë, Fakulteti i Studimeve të Biznesit dhe Fakulteti i Teknologjisë. Përgjegjës për administrimin e secilit prej fakulteteve janë: Këshilli i Fakultetit dhe Dekani. Institucionet e asocuara të Universitetit janë Instituti Levón dhe Tritonia Academic Library (Biblioteka Akademike e Tritonias). Punët e këtyre institucioneve të asocuara drejtohen dhe mbikëqyren nga një drejtor, i emëruar për këtë detyrë. Shërbimet administrative të fakulteteve të këtij Universitetit kryhen nga Shërbimet e Universitetit.

## Profili hulumtues

Hulumtimi në Universitetin e Vaasas bëhet, sipas standardeve bashkëkohore, në grupe hulumtimi të cilat shpeshherë janë grupe ndërkombëtare dhe multidisiplinore. Universiteti i Vaasas është i përkushtuar t'u përmbahet udhëzimeve për zhvillim të përgjegjshëm të hulumtimit, të publikuara nga *Bordi Këshillëdhënës finlandez për Integritetin e Hulumtimit (TENK)*.

Aktivitetet hulumtuese të Universitetit organizohen ashtu që të mund të kryhen nga grupe të disiplinës së veçantë hulumtuese apo nga grupe multidisiplinore, të cilat realizojnë projekte hulumtuese dhe i mbikëqyrin doktorantët.

Në fokusin e fushës së hulumtimit të Universitetit janë: Energjia, Financat, Menaxhmenti dhe Multilingualizmi. Synimet strategjike të hulumtimit janë:

1. Që hulumtimi dhe shkollimi postdiplomik të jetë më tepër me karakter ndërkombëtar.
2. Që të rritet pjesëmarrja kombëtare e universitetit në shkollimin postdiplomik, veprimtarinë e publikimeve ndërkombëtare dhe financimin e hulumtimeve në të gjitha fushat.
3. Që grupet më të mira të hulumtimit të arrijnë standard të lartë dhe të pranuar ndërkombëtarisht

Këto synime strategjike do të realizohen përmes grupeve të hulumtimit, fakulteteve, mundësive të punësimit gjatë dhe pas studimeve dhe me publikime.

Financimi i hulumtimit mbulohet 75% nga Ministria e Edukimit (financim i bazuar në objektiva dhe rezultate, i përcaktuar, çdo tre vite, me negociata në mes të Universitetit dhe Ministrisë,), dhe 25% nga burime të jashtme të financimit si agjencitë kombëtare të financimit të hulumtimeve (p.sh. Tekes, Akademia e Finlandës), fondacione private, kompani private, Bashkimit European dhe agjenci të tjera të financimit publik.

Grupet e hulumtimit përbëhen nga profesorë, hulumtues post-doktoralë, doktorantë që janë duke përfunduar disertacionet

dhe projektet e tyre të hulumtimit. Grupet hulumtuese, shpeshherë janë pjesë e rrjeteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Universiteti i Vaasas numëron 200 projekte hulumtimi, nga ku Technobothnia dhe Instituti i Energjisë së Vaasa mund të veçohen si projektet kryesore hulumtuese.

Technobothnia është laborator i përbashkët i mësimdhënies dhe hulumtimit i tri institucioneve të arsimit të lartë në Vaasa. Instituti i Energjisë i Vaasas është platformë e përbashkët hulumtimi për tri institucione të arsimit të lartë: Universitetin e Vaasas, Universitetin e Vaasas të Shkencave të Aplikuara dhe Universitetin Novia të Shkencave të Aplikuara.




Foto 8 – Fushat kryesore të hulumtimit në Universitetin Vaasa



## Shkollimi i doktoraturës

Në vitin 2011, Universiteti i Vaasas themeloi Shkollën e diplomimit me katër programe të doktoratës: Shkenca Administrative, Gjuhët dhe Komunikimi, Studime të Biznesit dhe Shkencat Teknike. Qëllimi i kësaj shkolle është të sigurojë që të gjithë doktorantët në Universitetin e Vaasas të kenë mundësinë të ndjekin programe cilësore të studimeve për doktoraturë. Shkolla në të njëjtën kohë e mbështetë planifikimin e studimeve të doktoraturës, punës hulumtuese dhe rrjedhës së studimeve. Më herët shkollimi në nivel doktrature kryesisht është përgatitur nga fakultetet e megjithatë është aplikuar struktura e njëjtë e akumulimit të kredive (240 ECTS).

Të gjithë doktorantët i përkasin shkollës postdiplomike dhe njërit prej programeve të doktoraturës. Secili program doktoral kryesohet nga një profesor i lëndës në fushën kryesore. Profesorë të tjerë kryejnë rolin e mbikëqyrësit për studentët përkatës të doktoraturës. Doktorantët dhe anëtarë të tjerë të grupeve hulumtuese veprojnë si mentorë (jozyrtarë). Ekziston edhe stafi hulumtues, që jep mësim në kurset e ndryshme të doktoraturës, ndërsa stafi administrativ është përgjegjës për këshillime, organizim të kurseve dhe regjistrim, kreditë e studimit, përgatitje të procesit të disertacioneve, publikimit të punimeve etj. Të gjitha programet e doktoraturës në Universitet bazohen në hulumtim. Universiteti i Vaasas financohet nga Ministria e Arsimit, derisa paratë nuk janë të dedikuara për shkollim doktrature, i takon Universitetit të vendosë mbi mënyrën e organizimit të arsimit të doktoraturës brenda kornizës së buxhetit të vet.

■ Doktorantët e diplomuar në vit  
■ Doktorantët e regjistruar




Foto 9 Doktorantët e regjistruar dhe të diplomuar në vit; Universiteti i Vaasa-së

Për të arritur gradën Doktor Shkence, studenti duhet të akumulojë 240 ECTS, nga këto 180-200 ECTS janë nga puna në disertacioni, ndërsa 40-60 ECTS janë nga kurset doktorale. 240 ECTS është norma e përgjithshme dhe synimi është që programi i doktoraturës të finalizohet në një periudhë kohore prej katër vitesh.

Doktorantët punojnë si anëtarë të grupeve hulumtuese universitare. Shumica e grupeve hulumtuese kanë bashkëpunim aktiv me shoqërinë dhe ekonominë (p.sh. projekte të përbashkëta hulumtimi). Universiteti i Vaasas gjithashtu ofron mundësi ndërkombëtare për doktorantët sipas termave të kontakteve ndërkombëtare dhe projekteve ndërkombëtare të grupeve hulumtuese të cilave iu përkasin. Studentët inkurajohen të marrin pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe të ndërmarrin periudha mobiliteti gjatë studimeve të tyre. Për më tepër, shkollat postdiplomike në nivel kombëtar ofrojnë kurse të përbashkëta të doktoratës, workshop-e dhe seminare për studentë nga universitete të ndryshme.

Vetë punimi i disertacionit, mund të jetë një hulumtim i vetëm (monografi) ose përmbledhje e disa publikimeve akademike apo të dorëshkrimeve të pranura për publikim. Disertacionet që përbëhen nga disa publikime mund të jenë artikuj të ndryshëm apo ese. Sipas Ligjit të Gradave (Degree Decree) (794/2004, Paragrafi 22), një disertacion mund të jetë i pranueshëm nëse përbëhet nga publikime shkencore ose dorëshkrime të pranura për publikim, që lidhen me problemin e njëjtë të hulumtimit, që janë në një numër që konsiderohet i mjaftueshëm nga Universiteti dhe që ka një përmbledhje të shkruar për këto publikime, ose ndonjë punim tjetër i cili i përmbush kriteret shkencore përkatëse. Publikimet mund të jenë edhe të përbashkëta në qoftë se pjesa e punës së pavarur të doktorantit mund të dallohet qartë në punim.

Bordi i fakultetit cakton së paku dy para-vlerësues të hulumtimit, që duhet të jenë nga jashtë fakultetit. Bazuar në raportin e para-vlerësuesve, Bordi i Fakultetit vendos të japë të drejtën e mbrojtjes së disertacionit. Kandidatit i jepet një mundësi të reagojë ndaj raportit të para-ekzaminuesve. Pasi t'i jetë dhënë leja, bordi i fakultetit cakton një ose dy kundërshtarë për të ekzaminuar disertacionin dhe një Profesor apo Profesor-Asistent për të qenë Kustos në proceset e doktorimit. Pas provimit publik, kundërshtari i emëruar nga Bordi i fakultetit duhet të japë një raport me shkrim për punimin e disertacionit në një afat të caktuar nga fakulteti. Kandidatit duhet t'i jepet mundësia për t'u përgjigjur ndaj deklaratave të Oponentëve. Bordi i fakultetit merr vendimin për ta pranuar apo refuzuar disertacionin dhe e vlerëson atë duke dhënë notën finale.

Programet doktorale në Universitetin e Vaasas dhe kurikulat e tyre janë të lidhura me shoqërinë, ekonominë dhe tregun e punës.

Mesatarisht në Universitetin e Vaasas doktorojnë 20 doktorantë në vit dhe zakonisht e fillojnë punën në fushat si në vijim:




Foto 10 – Sektorët e punësueshmërisë së Universitetit të Vaasa ku nisin punën Doktorët e rin te Shkencave

Doktorantët e Universitetit të Vaasas mund të kërkojnë lloje të ndryshme grantesh gjatë studimeve, siç janë:




Foto 11 – Granet që një doktorant mund t'i kërkojë në Universitetin e Vaasa



# Universiteti i Prishtinës

## Profil i Universitetit

Universiteti i Prishtinës është institucion i pavarur publik i arsimit të lartë, i angazhuar për mësimdhënie akademike, hulumtim shkencor, veprimtari artistike, këshillime profesionale dhe veprimtari të tjera në kuadër të aktiviteteve akademike. Ky institucion njëherësh është edhe institucioni më i rëndësishëm arsimor, shkencor dhe kulturor në Kosovë. Është Universiteti i vetëm që ofron studime në nivel të doktoraturës.

Megjithëse është një institucion relativisht i ri veprimtaria e tij arsimore, shkencore dhe artistike ka dhënë rezultate të konsiderueshme, të pamohueshme dhe historikisht të rëndësishme. Përveç kësaj Universiteti i Prishtinës është ndër institucionet e para të arsimit të lartë të rajonit që ka nisur procesin e reformës sipas Procesit të Bolonjës. Zbatimi i reformës ka nisur në vitin akademik 2001/2002 dhe vazhdon akoma deri sot.

Universiteti ka 14 Fakultete dhe rreth 2000 punonjës, nga të cilët rreth 1600 janë mësimdhënës dhe 400 të tjerë janë punonjës të administratës. Universiteti ka përafërsisht 52.000 studentë të rregullt dhe me korrespondencë në të gjitha nivelet e studimeve (rreth 80% në studime themelore, rreth 19% në Master dhe rreth 1% në nivel doktorature).

Universiteti përbëhet nga njësitë akademike dhe ato organizative. Njësitë akademike të Universitetit janë: 1. Fakultetet, dhe 2. Fakultetet e Shkencave të Aplikuara. Fakultetet në vijim veprojnë brenda Universitetit: Fakulteti Filozofik; Fakulteti i Shkencave Matematikore-Natyrore; Fakulteti i Filologjisë; Fakulteti Juridik; Fakulteti Ekonomik; Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës; Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike; Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike; Fakulteti i Mjekësisë; Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë; Fakulteti i Arteve; Fakulteti i Edukatës Fizike dhe i Sporteve dhe Fakulteti i Edukimit. Nga Fakultetet e Shkencave të Aplikuara është Fakulteti i shkencave teknike të Aplikuara në Ferizaj. Njësitë organizative në kuadër të Universitetit janë: Zyra për Marrëdhënies me Jashtë; Zyra e Teknologjisë Informative dhe Zyra për Zhvillim Akademik, Njësia për Barazi Gjinore dhe Zyra për Çështje Akademike. Përveç kësaj Universi-

teti i ka edhe këto struktura::

1. Qendrën Klinike Universitare (që menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë)
2. Qendrën për të Drejtat e Njeriut;
3. Qendrën për Ekselencë në Mësimdhënie dhe
4. Qendrën për Zhvillim të Karrierës .

Aktualisht, qeveria ndan rreth 70% të buxhetit ndërsa pjesa tjetër e të ardhurave sigurohet nga pagesat e studentëve, si dhe një kontribut i vogël nga shërbime të ndryshme që ofrojnë institutet, veçanërisht ato teknike. Prandaj ekzistojnë disa kufizime për mënyrën se si Universiteti zgjedh për të harxhuar mjetet. Rektori në bazë të këshillimeve me Këshillin Drejtues të Universitetit e përcakton buxhetin vjetor për aktivitetet e Parlamentit Studentor dhe për Këshillat Studentore. Këshilli Drejtues nxjerr rregullore për punën e Parlamenti Studentor dhe Këshillat e Studentëve sipas propozimeve të Senatit.





Përkundër çfarëdo vështirësish, ekzistojnë dëshmi për iniciativa modeste të hulumtimit shkencor dhe artistik, që kryesisht bëhen në formën e studimeve të doktoraturës dhe bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare.

Universiteti i Prishtinës kryesisht e fokuson strategjinë e vet drejt:

**1. Zhvillimit të kapaciteteve njerëzore:**

- 1.1 Mbështetjes për njësitë akademike që zhvillojnë programe të doktoraturës sipas sistemit të Bolonjës.
- 1.2 Krijimit të skemave të bursave për vizita të shkurta hulumtuese jashtë vendit për punonjësit akademikë.
- 1.3 Nxitjes të qasjeve ndërdisiplinore për veprimtaritë shkencore dhe artistike.
- 1.4 Zhvillimit të kriterëve për të siguruar iniciativa materiale për punonjësit e inkorporuar në hulumtime shkencore dhe veprimtari artistike.
- 1.5 Inkurajimit për përfshirjen e ekspertizës nga diaspora.
- 1.6 Hartimit dhe miratimit të detyrimeve kontraktuale për punonjësit akademikë.

**2. Përmirësimit dhe rritjes së infrastrukturës:**

- 2.1. Hartimit të një batë dhënash të kapaciteteve ekzistuese aktuale në Universitetin e Prishtinës.
- 2.2. Krijimin e mekanizmave dhe procedurave për shfrytëzimin e përbashkët të laboratorëve dhe hapësirave apo pajisjeve përbrenda Universitetit.
- 2.3 Nënshkrimin e marrëveshjeve për shfrytëzimin e infrastrukturës hulumtuese.
- 2.4 Sigurimin e infrastrukturës së nevojshme.
- 2.5 Sigurimin e qasjes në bibliotekat e rëndësishme elektronike.

**3. Ndërkombëtarizimit:**

- 3.1. Krijimin e partneriteteve strategjike me institucionet me repute ndërkombëtare.
- 3.2. Organizimin e trajnimeve dhe ofrimin e ndihmës teknike për zhvillimin e projekteve.

- 3.3. Ndarjen e fondeve për bashkëfinancim të projekteve ndërkombëtare.
- 3.4. Botimin/shpërndarjen e informatës për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar.

**4. Bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat:**

- 4.1. Krijimin e një baze të dhënash të bashkëpunimit me sektorin publik dhe atë privat në projekte.
- 4.2. Zhvillimin e mekanizmave dhe instrumenteve të nevojshëm për të siguruar që projektet me kohëzgjatje të ndryshme t'i plotësojnë më mirë nevojat e tregut.
- 4.3. Inkurajimin e përfshirjes së enteve shoqërore dhe ekonomike në hartimin dhe zbatimin e programeve akademike të orientuara kah hulumtimi.

Akoma nuk ka një buxhet që rezervohet ekskluzivisht për hulumtim. Megjithatë, sipas kapaciteteve financiare Universiteti i Prishtinës për çdo vit përkrah ndonjë laborator me infrastrukturë themelore dhe me metoda hulumtimi, botime dhe pjesëmarrje në konferenca, disa hapësira dhe pajisje të vogla për një bazë të hulumtimit kryesisht për qëllime arsimimi. Aktivitetet kryesore hulumtuese bazohen në bashkëpunimin me komunitetet ndërkombëtare të hulumtimit (projekte të përbashkëta, mbështetje të projekteve etj.) dhe grante kombëtare (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë - përmes Programit Kombëtar për Hulumtim Shkencor, fonde të tjera qeveritare) dhe fare pak nga bashkëpunimi me industrinë.



Foto 12 - Fushat kryesore të hulumtimit në Universitetin e Prishtinës

- (1) Të ndërtohet dhe përmirësohet dija, të zhvillohen praktika të reja, relevante artistike dhe të gjitha këto të zbatohen;
- (2) Të shkollohen hulumtues të dalluar dhe studiues në fushat e përcaktuara të shkencës dhe artit;
- (3) T'u mundësohet doktorantëve të bëjnë punë të pavarur në shkencë dhe art, të bëjnë hulumtime të pavarura dhe të bëjnë vlerësime kritike të veprave të artistëve të tjerë.
- (4) Të përfitohet dije, përvojë dhe aftësi që do t'ua mundësojë doktorëve të shkencës të gjejnë mënyra kreative të gjetjes së zgjidhje për probleme komplekse ekonomike dhe shoqërore mbi bazën e hulumtimit të tyre.
- (5) Të ndërkombëtarizohet puna hulumtuese shkencore dhe artistike që bëhet në Universitetin e Prishtinës

Këto janë objektivat e studimeve të doktoraturës në Universitetin e Prishtinës.<sup>12</sup>

Në fillim programi i doktoraturës në Universitetin e Prishtinës ishte 100% punë në disertacion. Me 2008 për herë të parë, Universiteti hartoi një rregullore për studimet e doktoraturës kryesisht me qëllim për të zhvilluar një kornizë të procesit të doktoratës. Sipas Nenit 49, pika 8 e Statutit të Universitetit të Prishtinës, Senati i Universitetit me 2010 ka miratuar rregulloren e re të studimeve të doktoraturës e cila rregullon organizimin dhe zbatimin e studimeve të doktoraturës në Universitetin e Prishtinës. Kjo rregullore u rishqyrtuar me 2013 me qëllim që të ndjek tendencat e arsimit të lartë sipas Bolonjës. Aktualisht të 24 programet e doktoraturës që ofrohen janë të bazuara në hulumtim; ato i mbulojnë këto fusha të studimit: Shkencat Bujqësore, Inxhinieri dhe Teknologji, Shkencat Humane, Gjuhët dhe Shkencat e Filologjisë, Drejtësinë, Matematikën dhe Informatikën, Shkencat Mjekësore, Shkencat Natyrore dhe Shkencat Shoqërore.




Foto 13 - Doktorantët e regjistruar dhe të Diplomuar në vit; Universiteti i Prishtinës

Programet e doktoraturës të Universitetit si dhe kurikulat e tyre janë të lidhur me shoqërinë, ekonominë dhe tregun e punës. Universiteti i Prishtinës nuk merr fonde ekskluzivisht për programet e doktoraturës. Megjithatë studentët kanë mundësi të kërkojnë grante të ndryshme:




Foto 14 - Grantet për të cilat mund të konkurrojnë një doktorant në Universitetin e Prishtinës

Me qëllim që të sigurojë cilësi dhe të promovojë mobilitetin e doktorantëve dhe të mësimdhënësve, studimet e doktoraturës janë të hapura ndaj çdo forme të bashkëpunimit me institucione të ngjashme të vendit apo të huaja. Studimet e doktoraturës udhëhiqen nga Komisioni i Studimeve të Doktoraturës. Në Universitetin e Prishtinës ekzistojnë disa forma të ndryshme studimi: 1. Studime të doktoraturës ku institucioni përgjegjës është vetëm një njësi akademike apo vet Universiteti; 2. Studime të përbashkëta nga dy apo më shumë universitete, por ku vetëm njëra është institucioni përgjegjës; 3. Modeli sandwich ku doktoranti regjistrohet në një program doktorature të një universiteti por hulumtimin e bën në disa institucione dhe ka disa bashkë-mentorë, po diplomën e merr nga institucioni përgjegjës, dhe 4. Studimet e përbashkëta ku programi i doktoraturës akreditohet në dy a më shumë universitete dhe doktoranti mund të marrë diplomën e përbashkët të dy a më shumë universiteteve, ose vetëm një diplomë të universitetit ku i ai/a jo i ka regjistruar studimet.

Në këtë Universitet Studimet e Doktoraturës organizohen në kohëzgjatje prej gjashtë semestrash: Gjatë semestrit të parë (1) - studenti mund t'i akumulojë 30 kredi ECTS nga tre lëndë të specialitetit të ngushtë nga fusha e studimeve që ka regjistruar; gjatë semestrit të dytë (2) studenti duhet

t'i akumulojë 30 kredi ECTS nga seminare nga tri grupime prej tri lëndësh të fushës së studimeve; gjatë **semestrit të tretë (3)** studenti do t'i marrë 30 kredi ECTS nga projekt propozimi për punimin e disertacionit kur ky propozim të jetë vlerësuar pozitivisht dhe të jetë miratuar nga Komisioni i Studimeve të Doktoratës nga njësia akademike përkatëse dhe të jetë miratuar nga Komisioni Qendror i Studimeve të Doktoraturës dhe pas caktimit të mentorit nga ana e Senatit; gjatë **semestrit të katërt (4)** studenti akumulon 30 kredi ECTS duke publikuar pjesë nga rezultatet e disertacionit të tyre në ndonjë revistë me recension ndërkombëtar të fushës respektive ose me pjesëmarrje dhe prezantim në ndonjë takim të rëndësishëm ndërkombëtar; në **semestrat pesë (5) dhe gjashtë (6)** studenti merr 60 kredi ECTS për mbrojtjen publike të disertacionit të tij/saj.

Punimi i disertacionit së bashku me pajtimin me shkrim dhe me nënshkrimin e mentorit si dhe me mendimin e tij për hulumtimin e bërë dhe për arritjet dhe kontributin origjinal shkencor të kandidatit i dorëzohet Fakultetit apo Universitetit në mënyrë formale, në formë elektronike dhe në kopje fizike. Në rastet e veprave artistike të doktoraturës, doktoranti krahas prezantimit publik të veprës, duhet të dorëzojë edhe pjesën teorike, si edhe dokumentet e kërkuara për vlerësim.

Komisioni i Studimeve të Doktoraturës së njësisë akademike sipas propozimit të Komisionit të Studimeve të Doktoraturës emëron Komisionin për Vlerësimin e Punimit që përbëhet prej tre ose pesë anëtarëve që së paku duhet të kenë titullin akademik Profesor Asistent (Prof. Ass.). Inkurajohet përfshirja e së paku një anëtari nga një Universitet i huaj. Mentori nuk mund të jetë anëtar i komisionit. Gjatë kohës së emërimit të Komisionit për Vlerësimin e Punimit Universiteti e publikon titullin, resumenë e punimit në shqip dhe anglisht në web faqen e Universitetit, duke mundësuar që punimi të vihet në shqyrtim publik të kritikës shkencore dhe profesionale. Anëtarët e Komisionit dhe kushdo tjetër që e ka mundësinë për të shqyrtuar punimin është i obliguar që t'i trajtojë shënimet me kofidencë para publikimit të vlerësimit të punimit me qëllim të ruajtjes së kontributit shkencor të disertacionit si pronë intelektuale.

Komisioni ka për detyrë të hartojë një raport me shkrim të vlerësimit të punimit. Kryetari i Komisionit e përgatitë raportin sipas

mendimit me shkrim të anëtarëve. Raporti duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Megjithatë secili anëtar i komisionit e ka të drejtë që të paraqesë ndaras vlerësimin e vet individual.

Komisioni mund të propozojë që: 1. Pranimin e punimit me një deklaratë eksplicite për origjinalitetin e kontributit shkencor apo artistik, apo 2. rishikimin e punimit dhe të vlerësimit final, ose 3. refuzimin e punimit, në këtë rast doktoranti e hup të drejtën për të marrë gradën Doktor Shkence apo Arti me punimin e dorëzuar. Arsytimi është pjesë e detyrueshme e raportit. Këshilli i njësisë akademike në mbledhjen e parë të radhës i propozon Senatit ngritjen e Komisionit për mbrojtjen e Disertacionit mbi bazën e propozimit të Komisionit të Studimeve të Doktoraturës. Doktoranti mund të mbrojë disertacionin e vet pasi Këshilli i Fakultetit ka miratuar vlerësimin pozitiv të Komisionit për Vlerësimin e Punimit i cili duhet të aprovohet nga Senati në një afat prej dy muajsh nda dita kur dorëzohet te Komisioni Qendror i Studimeve të Doktoraturës. Doktoranti në marrëveshje me dekanin e njësisë akademike dhe me Komisionin për Mbrojtjen e Punimit caktojnë datën dhe kohën e mbrojtjes së punimit.

Komisioni për Mbrojtjen e Disertacionit përbëhet gjithashtu prej tre ose pesë anëtarëve. Komisioni i Mbrojtjes mund të jetë i njëjti Komision për Vlerësimin e Punimit, përveç mentorit. Mentori merr pjesë në mbrojtjen e punimit në anën e doktorantit po nuk ka të drejtë vote. Mbrojtja e doktoraturës është publike. Informata për mbrojtjen publike të temës duhet të publikohet në ndonjërin nga gazetatat lokale, më së paku tetë ditë para ditës së mbrojtjes. Mbrojtja duhet të organizohet brenda hapësirave të Universitetit, në kuadër të njësisë akademike, në gjuhën në të cilën është shkruar punimi. Në rastet e disertacioneve të përbashkëta ka mundësi që mbrojtja të bëhet në ndonjë universitet tjetër. Procedura e mbrojtjes rregullohet me protokoll. Komisioni i Mbrojtjes e bën vlerësimin menjëherë pas mbrojtjes publike. Vlerësimi mund të jetë: 1. Kandidati e mbrojti me sukses punimin ose 2. Kandidati nuk e mbrojti punimin. Vendimi merret me shumicë votash, që vërtetohet me nënshkrime.

Të diplomuarit në Universitetin e Prishtinës zakonisht nisin punën në njërin nga sektorët në vijim:



Foto 15 - Sektorët e punësueshmërisë ku Doktorët e Shkencave të Universitetit të Prishtinës e fillojnë punën.



# Programi i doktoraturës „Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit” në Universitetin e Prishtinës

## (1) Programi

Kudo në botë, e sidomos në Kosovë, ekziston nevoja për ekspertë të kualifikuar në shkencën, prodhimin dhe procesimin e ushqimit. Për këtë arsye Universiteti i Prishtinës në bashkëpunim me universitetet europiane: Universitetin e Gracit, Universitetin Teknik të Munich-ut, Universitetin e Grënadës dhe Universitetin e Vaasas, si dhe me institucione vendore dhe ndërkombëtare hartuan projektin për zhvillimin e një programi të doktoraturës në Shkencën dhe Teknologjinë e ushqimit: *“Doktoraturë në Shkencat dhe Teknologjinë e Ushqimit dhe Ngritja e Kapaciteteve për Reformën e Programeve të Doktoraturës në Universitetin e Prishtinës - PhD@UP”*, dhe konkurruan në TEMPUS. Ky program ndërdisiplinor i doktoraturës përfshinë Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV), Fakultetin e Shkencave Matematikor Natyrore (FShMN) dhe Fakultetin e Mjekësisë (FM) të Universitetit të Prishtinës.



## Struktura, zhvillimi dhe Zbatimi

Programi i doktoraturës “Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit” është program tre-vjeçar, i cili ka gjithsej 180 ECTS, 60 ECTS i ka prej kurseve dhe 120 ECTS nga hulumtimi, është i strukturuar si në vijim:

Gjatë semestrit të parë ofrohen tetë module me zgjedhje, secili student duhet të përmbushë nga tri prej tyre me një ngarkesë punë,

që në total është e barabartë me 30 ECTS (10 ECTS për një modul). Secili student mund të përzgjedhë nga tetë modulet në vijim:

- A) Nutricioni dhe Shëndeti publik
- B) Bioteknologjia
- C) Prodhimi i ushqimit
- D) Analizat kimike dhe fizike të ushqimit
- E) Teknologjia e ushqimit dhe pijeve
- F) Teknika të matjeve ambientale
- G) Kualiteti dhe parrezikshmëria e ushqimit
- H) Politikat, strategjitë dhe legjislatura për ushqimit në BE dhe në Kosovë.

Gjatë semestrit të dytë ofrohen tetë seminare me zgjedhje, dhe secili student duhet të përmbushë tri prej tyre, kjo paraqet gjithsej 30 ECTS (10 ECTS për seminar). Secili student mund të përzgjedhë nga lista prej tetë seminareve në vijim:

- A) Mikrobiologjia e ushqimit
- B) Bioinformatika dhe klubi i revistave
- C) Nutricioni klinik
- D) Gjenetika e aplikuar
- E) Kimia fizike
- F) Nutricioni eksperimental
- G) Arsimimi nutritional dhe promovimi

120 ECTS që mbeten janë caktuar të fitohen nga hulumtimi dhe përgatitja e disertacionit.

Secili projekt disertacioni mbikëqyret nga një mentor nga Universiteti i Prishtinës si dhe bashkë-mentorët nga universitetet partnere. Zakonisht mentorimi bëhet nga Profesorë të Rregullt dhe ata të Asocuar po në rastet kur ka mungesë të profesorëve nga fusha përkatëse, mentorimi mund të bëhet edhe nga Profesorë Asistentë dhe Emeritus.

Universitetet partnere janë të përfshira drejtpërsëdrejti në zbatimin e programit të doktoraturës duke sjellë profesorë vizitor për të

mbajtur ligjërata, përmes trajnimeve praktike për hulumtime dhe përdorimit të pajisjeve, që bëhen nga profesorë të Universitetit të Munich-ut dhe Universitetit të Grënadës. Kontributi i Universitetit të Gracit, Universitetit të Vaasas dhe ÖAD për organizimin e programit u dha përmes ekspertizës që ofruan gjatë vizitave dhe trajnimeve studimore.

Programi është akredituar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit. Pajisjet e domosdoshme për hulumtim dhe mësimdhënie i janë dhënë Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë ku edhe janë instaluar.



## Procedurat e paraqitjes dhe përzgjedhjes

Konkursi i parë publik për pranimin e kandidatëve në programin e doktoraturës “Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit”, është shpallur në ueb faqen e Universitetit të Prishtinës si dhe në gazetën ditore dhe ishte i hapur nga data 1 deri 15 dhjetor 2012.

Ky program synonte studentët nga Shkencat Natyrore (Bujqësi, Veterinari Mjekësi, Biologji, Nutricion etj) që kanë interesim për shkencën dhe teknologjinë e ushqimit, të cilët me mbarimin e këtyre studimeve do të merrnin titullin Doktor Shkenca.

Kriteri tjetër i përzgjedhjes ishte mesatarja e studimeve të mëparshme të studentëve, numri i punimeve të botuara si dhe njohja e gjuhës angleze. Në konkurs u paraqitën 74 kandidatë nga të cilët 40 e kaluan vlerësimin teknik. Në fund u përzgjedhën 15 studentë (8 femra dhe 7 meshkuj), të cilët u pranuan në programin e doktoraturës. Përzgjedhja u bazua në letrën e motivimit që duhej shkruar në një temë nga fusha e shkencës

dhe teknologjisë së ushqimit, si dhe në intervistat që u bënë si hap i fundit në procesin e përzgjedhjes. Komisioni i përzgjedhjes së studentëve përbëhej nga katër profesorë të Universitetit të Prishtinës (Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë; F. i Shkencave Matematiko-Natyrore dhe Mjekësisë) dhe nga një profesor i Universitetit të Grënadës.




Foto 17 - Përmbledhje e konkurrencës në programin doktorat „Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit”




Foto 18 - Studentët e përzgjedhur të programit doktorat në „Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit” sipas gjinisë.

## Studentët

Gjenerata e parë e studentëve të programit të doktoraturës “Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit” janë kryesisht shqiptarë nga Kosova që kanë përfunduar studimet e tyre në Universitete të ndryshme të Kosovës apo jashtë vendit. Tetë prej tyre kanë përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës, katër në Universitetin e Tiranës, një në Londër, një në Cyrih dhe një në Universitetin e Sarajevës.

Gjashtë studentë kanë një prapavijë nga shkencat natyrore (tre nga biologjia dhe tre nga kimi), katër nga mjekësia (dy doktorë dhe dy farmacistë), tre nga veterinaria dhe dy nga teknologjia ushqimore.




Foto 18 - Prapavija e studentëve të përzgjedhur – Programi i doktoraturës në “Shkencën dhe Teknologjinë e Ushqimit”

Gjatë studimeve të tyre të doktoraturës, studentët do të duhet

të zhvillojnë një mobilitet në njërin nga universitetet partnere me qëndrim prej 1 deri 3 muaj, për të cilin studentët do të marrin një grant që bashkë-financohet nga projekti i TEMPUS dhe nga Universiteti i Prishtinës. Mobiliteti synon që t'u mundësojë studenteve që të bashkëpunojnë në mënyrë aktive me grupet e hulumtimit të universiteteve respektive.

### Financimi

Zbatimi i programit u bashkë-financua nga projekti TEMPUS. Me mbështetjen e projektit të TEMPUS është pajisur në mënyrë adekuate një laborator i veçantë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë. Projekti gjithashtu ka mbështetur qëndrimet studimore të studentëve nëpër universitetet partnere për 1-3 muaj dhe pjesërisht ka mbuluar bashkë-mësimdhënien dhe bashkëmbikëqyrjen e studentëve në formën e një financimi inicial. Në të ardhmen këto shpenzime duhet të mbulojnë nga Universiteti i Prishtinës ose duhet siguruar fonde shtesë. Kësaj radhe Universiteti mbulon pagat e të gjithë mësimdhënësve në semestrin parë dhe të dytë si dhe pagat e mentorëve dhe të anëtarëve të komisioneve të ndryshme që janë përfshirë në procedurën e përgatitjes dhe të mbrojtjes së punimit të doktoraturës.

### Ndërkombëtarizimi

Ky program *ndjek një nivel të lartë të ndërkombëtarizimit* duke zhvilluar *një program të përbashkët doktorature* dhe duke përfshirë disa institucione dhe universitete kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për ta përmbledhur, përfshirja e ekspertëve nga fusha e shkencës dhe teknologjisë së ushqimit në njërin anë dhe në anën tjetër përfshirja e ekspertëve nga fusha e zhvillimit të strukturave dhe programeve të doktoraturës, solli zhvillimin e *një programi të doktoraturës të një cilësie të lartë dhe në një linjë me standardet e Bolonjës*.

Ky trend ndërkombëtar do të vazhdohet edhe gjatë zbatimit të programit të doktoraturës përmes organizimit të *bashkë-mësimdhënies dhe përmes hulumtimit të përbashkët* ku përfshihen punonjësit nga Universiteti i Prishtinës, nga Universiteti Teknik i

Mynihut dhe nga Universiteti i Grënadës. Rrjedhimisht, *të gjitha modulet dhe seminarët janë zhvilluar me punë të përbashkët* dhe zbatohen nga mësimdhënës të universiteteve të përmendura. Përveç kësaj, të gjithë doktorantët janë të obliguar të bëjnë një *qëndrim hulumtimi* për së paku prej 1-3 muaj në njërin prej *universiteteve partnere*. Kjo masë ndërkombëtarizimi jo vetëm që do të shtojë shanset e tyre në tregun e punës por do t'i ofrojë shumë mundësi për të zgjeruar njohjet e tyre akademike si dhe të fitojnë përvoja të ndryshme në fushat e tyre të hulumtimit. Ky qëndrim hulumtimi duhet të ndodhë pas semestrit të dytë dhe mbulohet nga fondet e projektit.

### “Përbërësit që e bëjnë të suksesshëm një projekt pilot”

Thënë shkurt, një *analizë e nevojave* e saktë dhe korrekte si dhe *përcaktimi i përpiktë i profilit të kualifikimit* në kombinim me *perspektivë të qartë për mundësitë e punësimit në të ardhmen* qoftë në institucionet akademike, në ato të hulumtimit apo në tregun privat të punës janë parakushtet e rëndësishme për zbatimin e një programi të doktoraturës me cilësi të lartë. Në rastin e programit doktorat: “Shkencat dhe Teknologjia e Ushqimit”, hulumtuesit e rinj përfitojnë jo vetëm nga *interdisiplinariteti* i programit por gjithashtu edhe nga *niveli i lartë i ndërkombëtarizimit* dhe nga bashkëpunimi i disa universiteteve të ndryshme të cilat kanë një traditë të gjatë të arsimit doktorat.

### (2) Përvojat nga procesi i zhvillimit dhe zbatimit

Projekti “Programi i Doktoraturës në Shkencat dhe Teknologjinë e Ushqimit dhe Ngritja e kapaciteteve për Reformën e Programeve të Doktoraturës në Universitetin e Prishtinës” promovon bashkë-



punimin akademik me partnerë ndërkombëtarë; konsultimin me studentë dhe përfshirjen e tyre; partneritetet publike dhe private; siguron konsistencë dhe cilësi përmes partneritetit dhe bashkëpunimit në mes tyre; shkëmbimin e dijes dhe vlerësimin nga kolegët; procesin e ndërkombëtarizimit të hulumtimit; të mësimdhënies dhe të qasjes ndërdisiplinore.

Projekti ka një qasje të tillë që ofron mbështetje për sektorin e hulumtimit, politikave që bazohen në bujqësi, zhvillimin ekonomik, aspektet shëndetësore dhe të ambientit si dhe konceptin evropian të integritimit. Gjithashtu, inkurajon dhe krijon një mekanizëm për zhvillimin e programeve të doktoraturës në Universitetin e Prishtinës të bazuar në sistemin e Bolonjës.

Gjatë zhvillimit dhe zbatimit të këtij programi doktorat pati disa vështirësi po edhe disa përvoja pozitive. Aktualisht programi ka vështirësi për të siguruar bashkëfinancimin dhe qëndrueshmërinë e projektit për ato pjesë që akoma kanë nevojë për përmirësime. Aspekti pozitiv deri tani ka qenë transferimi i dijes dhe përvojës mes të gjithë partnerëve të projektit.

Pastaj, edhe Universiteti i Prishtinës ka marrë një mbështetje tejte të madhe veçanërisht për reformimin e kurikulave dhe për iniciimin e punës fundamentale hulumtuese. Përveç kësaj, ky është programi i parë doktorat që organizohet në Universitetin e Prishtinës në rrafshin e kompetencave dhe të ndërkombëtarizimit që i ngjan programeve të doktoraturës që ofrohen në Universitetet e rajonit.

### Situata aktuale

Aktualisht, procesi ka arritur te zbatimi i vitit të dytë ndërsa bashkëligjërimi me partnerët është gjithnjë duke vazhduar. Në fillim të vitit 2014 studentët filluan fazën e tyre të mobiliteteve me kohëzgjatje minimale prej një muaji. U diskutua edhe për bashkëmentorimi për disertacionet e tyre (sipas rregullores për studime të doktoraturës, të Universitetit të Prishtinës). Rreth 12 mësimdhënës vendorë kanë marrë pjesë apo vazhdojnë pjesëmarrjen e tyre në procesin e mësimdhënies dhe të hulumtimit. Për më tepër, rreth 10 profesorë dhe asistentë evropianë kanë marrë pjesë apo vazhdojnë të marrin pjesë në shkëmbimin e dijeve, në proceset e hulumtimit apo bëjnë vizita si ligjërues.

Krahas kësaj, në kuadër të projektit të TEMPUS po edhe me qëllim të zbatimit të programit të doktoraturës në Universitetin e Prish-

tinës, u pajis një laborator i biologjisë molekulare dhe bioteknologjisë. Përveç kësaj Universiteti i Prishtinës sistemonte Qendrën KIKT e cila është pajisur me pajisje të rëndësishme të hulumtimit dhe është financuar nga një projekt tjetër i TEMPUS. Gjithashtu edhe literatura e nevojshme për qëllim të zbatimit të këtij programi studimor është blerë dhe tani është në dispozicion të studentëve në Bibliotekën Universitare. Të gjitha këto hapësira dhe mjete janë në dispozicion të doktorantëve për të mbështetur punën e tyre hulumtuese. Duhet shtuar edhe se, Rektori i Universitetit të Prishtinës e ka udhëzuar menaxhmentin e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë për të bërë të gjitha përpjekjet për rekrutimin dhe regjistrimin e gjeneratës tjetër të studentëve në programin e doktoraturës “Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit”.





## Rezultate dhe Përfundimet

Gjatë zbatimit të këtij projekti të TEMPUS dhe të programit të doktoraturës në “Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit” u mblodhën rezultate të shumta.



Me qëllim të ilustrimit më të mirë të mënyrës se si lidhen rrafshet e ndryshme mes vetes, ky kapitull i raportit është organizuar sipas kësaj mënyre të lidhjes. Kështu rezultatet janë organizuar sipas rrafsheve: rrafshit kombëtar: hulumtimi kombëtar / strategjia e arsimit; në rrafshin universitar: strategjia e universitetit dhe në rrafshin e praktikës: zbatimi i programeve doktorate.

### Hulumtimi kombëtar / Strategjia e arsimit

Edhe pse “zhvillimi i hulumtimit dhe teknologjisë (ZHHT) në Kosovë mbetet akoma një ndërmarrësi margjinale”, MASHT-i dhe Këshilli Kombëtar i Shkencës kanë bërë një hap të rëndësishëm përpara duke siguruar një kornizë ligjore dhe strukturale për zgjerimin e veprimtarisë hulumtuese në Kosovë. Për më tepër, organizatat hulumtuese universitare dhe jouniversitare kanë identifikuar nevojën për shtim substancial të zhvillimit teknologjik si “ të rëndësishme instrumentale vitale për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës”<sup>13</sup>.

“Programi Kombëtar i Hulumtimit në Kosovë”<sup>14</sup> që u miratua nga Këshilli Kombëtar i Hulumtimit me 2010 për një periudhë pesëvjeçare, prandaj numëron 5 plus 1 prioritete e ato janë:

1. Burimet natyrore, energjia dhe ambienti
2. Prodhimet bujqësore dhe ushqime të sigurta
3. Hulumtimi mjekësor
4. Studimet ekonomike dhe shoqërore
5. Gjuhësia, studimet kulturore dhe historike
6. Hulumtimi trans-horizontale në informatikë dhe teknologjinë e komunikimit

Megjithatë, Instituti i Hulumtimit dhe Zhvillimit të Çështjeve Europiane (Research Institute of Development and European Affairs) në raportin e vet për gjendjen e hulumtimit në Kosovë me 2012, ka thënë se *Kosova ka një vëllim të vogël të veprimtarisë hulumtuese*.<sup>15</sup> Pastaj, nuk ka sistem të strukturuar sipas të cilit institucionet relevante do të mund të organizonin dhe raportonin veprimtarinë e vet hulumtuese. Sfidat që u identifikuan ishin si në vijim<sup>16</sup>:

- Sipas Raportit të Progresit të Komisionit European ka mungesë *investimesh për hulumtim*. Ekziston *nevoja urgjente që të krijohet një fond për hulumtime* që do të mbështeste veprimtarinë e hulumtuesve dhe *do të ndërtonte kapacitetet për institucionet hulumtuese*<sup>17</sup>
- Ka mungesë të *punonjësve të kualifikuar, numër të vogël të doktorantëve, pajisje të pamjaftueshme laboratorësh dhe njohuri të pamjaftueshme teknike*.

Kosova ndan vetëm 0.1 për qind të GDP për shkencë dhe hulumtime. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ndan 1.000.000 Euro që duhet të përdoren për të financuar projektet hulumtuuese nga gjashtë fusha të prioritetit.

Programet e doktoraturës në Universitetin e Prishtinës nuk e kanë bazën në hulumtime.

Autoritetet vendore kanë hartuar një numër të madh dokumentesh strategjike dhe të planeve të veprimit po përkundër kësaj nuk janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për zbatimin e tyre.

Sipas raportit të Komisionit Europian të vitit 2012, problemi kryesor në mesin e këtyre sfidave është mungesa e fondeve.<sup>18</sup>

### Strategjia e Universitetit

Megjithëse, “arsimi i lartë në Kosovë karakterizohet nga marginalizimi i hulumtimit shkencor”<sup>19</sup> në nivel institucional, nxjerrja e Rregullores për Studimet e doktoraturës në Universitetin e Prishtinës me 2010 dhe modifikimi i saj me 2013 kanë qenë një element shumë i rëndësishëm. Këto rregullore që bazohet në Statutin e Universitetit të Prishtinës paraqesin kornizën ligjore, strukturale dhe organizative për iniciimin e studimeve të doktoraturës që janë në linjë me Sistemin e Bolonjës dhe standardet ndërkombëtare europiane.

Megjithatë, sfida kryesore gjatë viteve të ardhshme do të jetë zbatimi si dhe realizimi i programeve të doktoraturës sipas këtyre rregullave.


Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) është themeluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës (MASHT) me anë të Urdhrit Administrativ: MASHT [I] 11/2004, 16.02.2004. Roli i AKA është të vlerësojë dhe akreditojë cilësinë veprimtarisë arsimore dhe shkencore, shërbimet profesionale të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në Kosovë, për të garantuar cilësinë e mësimdhënies në të gjitha institucionet publike (IP) dhe private (IP) të arsimit të lartë (AL). Për të siguruar plotësimin e kriterëve të akreditimit të institucioneve dhe programeve të tyre të studimit, në pajtim me kërkesat e përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Cilësisë, Zyra e Agjencisë Kosovare të Akreditimit ka hartuar udhëzuesin që përfshinë të gjitha kërkesat që një institucion që paraqet kërkesën për akreditim duhet t'i plotësojë dhe t'i konfirmojë me shkrim si pjesë të Raportit të Vlerësimit

dhe dokumentacionit tjetër. Në këtë rast, UP ka zhvilluar të gjithë mekanizmat e nevojshëm për të përshtatur të gjithë programet e studimit dhe gjithashtu siguron udhëzimet për hartimin sipas dizajnit të Raportit të Vetëvlerësimit (RVV) për vlerësim institucional dhe për programet e tyre të studimit (G1).

Mund të shihet se aktualisht më tepër se 50 për qind e zbatimit të programeve të reja të doktoraturës *që janë në një linjë me Sistemin e Bolonjës dhe të akredituara nga Agjencia Kosovare e Akreditimit*, mbulojnë *fushat e prioritetit të hulumtimit* në kuadër të Programit Kombëtar të Hulumtimit dhe të Planit Strategjik për vitet 2011-2016 të Arsimit të Kosovës (Shih tabelën në faqen tjetër):



	Zonat me prioritet të hulumtimit	Programet e doktoraturave në
1.	Burimet natyrore, energjia dhe ambienti	Biologjia e organizmave dhe ekologjia
2.	Prodhimet bujqësore dhe parrezikshmëria e ushqimit	Shkenca dhe Teknologjia e Ushqimit
3.	Hulumtimet mjekësore	Shëndeti publik Mjekësia paraklinike Stomatologjia Biomjekësia eksperimentale
4.	Shkencat shoqërore dhe ekonomike	Financat dhe kontabiliteti Menaxhimi dhe informatika Marketingu Ekonomiks
5.	Gjuhësi, studimet kulturore dhe historike	Gjuhësi histori
<i>Programe të doktoraturës të paklasifikuara në kuadër të zonave me prioritet të hulumtimit</i>		Kimi Letërsi Shkencat e komunikimit dhe gazetari Telekomunikim Shkencat kompjuterike Automatikë Të drejtat civile Ligji penal Drejtesia administrative dhe kushtetuese Ligji i financave Ligji ndërkombëtar



■ Numri i programeve të doktoraturës pa zonat me prioritet të hulumtimit  
 ■ Numri i programeve të doktoraturave bashkë me zonat me prioritet të hulumtimit

Mund të themi se duke ndjekur *Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit të Lartë në Kosovë (2005 - 2015)*, po bëhet harmonizimi i sistemit të arsimit të lartë kosovar me principet e Deklaratës së Bolonjës e me këtë qëllim i lehtësimit të integritetit të Kosovës në Zonën e Arsimit të lartë Europian është pjesërisht i plotësuar dhe është duke ecur në rrugë të mirë. Universiteti i Prishtinës po e përmbush këtë proces duke ofruar programe të doktoraturës të akredituar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) edhe për kah aspekti i *sigurimit të cilësisë*, term ky që është me rëndësi esenciale në Strategjinë e Arsimit të Lartë.

Modifikimi i Rregullores për Studime të Doktoraturës, të Universitetit të Prishtinës i bërë në vitin 2013, bëri disa ndryshime që sollën disa përmirësime siç janë:

1. *Numri i anëtarëve të Komisionit për studime të Doktoraturës të njësisë akademike* u zvogëlua prej 17 në 5-7 anëtarë. Ky ndryshim nxjerr një strukturë më të organizuar, le të themi, për vendim marrje.
2. *Studimet e doktoraturës mund të themelohen dhe të zbatohen* vetëm për ato fusha shkencore për të cilat *institucioni përgjegjës ka njohje ndërkombëtare* për rezultate të hulumtimit shkencor/artistik ose për kreativitet artistik që do të konfirmohen me akreditimin nga ana e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimit. Ky ndryshim është edhe një hap më tej drejt ndërkombëtarizimit të projekteve dhe programeve të doktoraturës në institucionet kosovare të arsimit të lartë.
3. *Një mentor mund të mbikëqyr deri në tre kandidatë* (ky numër është shtuar prej jo më shumë se dy në jo më shumë se tre kandidatë). Me këtë kërkohet përgatitje më të madhe të mentorit si dhe shkëmbim dhe ndërthurje të profileve të hulumtimit të doktorantëve dhe disertacioneve të tyre.

Për sa i përket ndërkombëtarizimit të projekteve hulumtuese dhe ofertës akademike, Universiteti i Prishtinës merr pjesë dhe përfiton nga veprimtari të ndryshme, projekte dhe iniciativa me qëllim të ngritjes së mundësive për të ofruar një *shkollim të nivelit ndërkombëtar* që përfshinë kurse që mbahen nga profesorë vizitorë, sigurimin e pajisjeve adekuate, mbajtjen e trajnimeve për përdorimin e laboratorëve dhe teknologjisë korresponduese si dhe qëndrimet hulumtuese në njërin nga institucionet partnere.

Siç u përmend më sipër, Universiteti i Prishtinës ka nisur zbatimin e programeve të reja të doktoraturës që janë në linjë me Sistemin e Bolonjës dhe që janë akredituar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit.

Gjeneratë e vitit akademik 2011/2012 është gjenerata e fundit me të cilën mbyllen që të gjithë 28 programet e vjetra të studimit doktorat.

Po t'i krahasojmë me programet e reja të doktoraturës, mund të shohim se Universiteti i Prishtinës ka shkëmbyer një pjesë të programeve të vjetra të doktoraturës me ofertën për programe të reja dhe krejtësisht të ndryshme (shih krahasimin më poshtë). Më pastaj, mund të shohim se Universiteti i Prishtinës *akoma nuk i ka kombinuar programet e (më hershme të) doktoraturës me ndonjërin nga programet e reja që kanë opsionin e disa linjave të hulumtimit* siç kanë bërë institucionet partnere të tij të projektit të TEMPUS. Prandaj ekziston një *mbivendosje mes programesh të ndryshme*. P.sh. në fushën e drejtësisë Universiteti i Prishtinës ofron 5 (!) programe të ndryshme të doktoraturës (shih listën më poshtë, programet që janë hijezuar me ngjyrë të gjelbër).

Programet e reja të doktoraturës që nga tetori 2012	Programet e vjetra të doktoraturës deri në vitin 2011/2012
Biologjia e organizmave dhe ekologjia	
Studimet e doktoraturës në kimi	Kimi
Studimet e doktoraturës në gjuhësi	Studime gjuhësore
Studimet e doktoraturës në letërsi	Studime letrare
Studimet e doktoraturës në shkencat e komunikimit dhe gazetarisë	
Shëndeti publik	
Mjekësia klinike	Kirurgji
Mjekësia paraklinike	Paraklinika
Stomatologjia	Stomatologji
	Mjekësi interne
	Kurse parandaluese
	Farmacit
Biomjekësia eksperimentale	
Telekomunikimi	
Shkencat kompjuterike	Shkencat kompjuterike
Automatikë	Automatikë
Histori	Histori
Të drejtat e njeriut	Drejtimi Civil
Ligji penal	Drejtimi i kriminalistikës
Ligji administrativ dhe kushtetues	Admistrimi kushtetues
Ligji i financave	
Ligji ndërkombëtar	
Banka, financa dhe kontabilitet	
Menaxhmenti dhe informatika	Menaxhmenti ndërkombëtar
Marketing	
Ekonomiks	
Shkenca dhe teknologjia e ushqimit	
	Sociologji
	Matematikë
	Letërsi angleze
	Gjuhë dhe letërsi frënge
	Gjuhë dhe letërsi gjermane
	Fundamental Engineering
	Kurse
	Elektronika
	Departamenti i minave
	Inxhinieri kimike
	Inxhinieri ambientaliste
	Menaxhim materialesh
	Menaxhim i metalurgjisë

Shembulli i institucioneve partnere të këtij projekti ka treguar se duhet të ketë *më shumë bashkëpunim brenda Universitetit* e gjithashtu edhe me institucionet tjera (ndërkombëtare). *Më shumë studime ndërdisiplinore* që përfshijnë disa fakultete apo departamente do të lehtësonin këtë bashkëpunim brenda-universitar.

*Një numër shumë i madh iniciativash individuale* si dhe të atyre që vijnë prej poshtë lartë e shënojnë procesin e zhvillimit të programeve të reja. Gjithë këto iniciativa duhet të *drejtohen dhe udhëzohen më mirë nga një strategji e menaxhimit të Universitetit*. Kësisoj, Universiteti i Prishtinës duhet t'i zbatojë dhe betonojë strategjitë institucionale me një plan zhvillimor të miratuar në mënyrë unanime.

Përveç kësaj, ekziston edhe një *nevojë urgjente për optimalizimin e infrastrukturës* për shkak të mungesës së pajisjeve dhe hapësirave për hulumtim.

Studimin i bërë nga Technopolis, për organizimin e studimeve të doktoraturës në Bashkësinë Europiane dhe në vendet fqinje, i lansuar në vitin 2010<sup>20</sup>, vë në pah se ka disa lloje pengesash që mund të numërohen si të tilla për shkak se *programet e doktoraturës nuk janë të lidhura me tregun* dhe nuk janë hartuar sipas nevojave të sektorit privat.

Tash për tash shumica e programeve të doktoraturës kryesisht e bëjnë shkollimin vetëm drejt një qëllimi, bie fjala *trajnohen studentët për t'u bërë mësimdhënës universitar*. Vetëm një numër fare i vogël i të diplomuarve gjejnë punë në sektorin privat apo diku në hulumtime. Përveç, kësaj shumë doktorë shkence kërkojnë ndonjë angazhim post-doktorat diku jashtë vendit.

Sfidat gjithashtu janë të dyfishta: *futja e çështjeve të tregut në programet e doktoraturës si dhe përfshirja e sektorit privat në hartimin dhe kryerjen e studimeve të doktoraturës*.<sup>21</sup>



Nga ana tjetër, që të gjitha iniciativat për sigurimin e cilësisë të programeve të doktoraturës mbështeten *të rritja e kapaciteteve hulumtuese në tërë Kosovën në përgjithësi dhe në veçanti të rritja e këtyre kapaciteteve në Universitetin e Prishtinës*.

MASHT e Kosovës në Planin Strategjik të Kosovës 2011-2016<sup>22</sup> ka treguar se Kosova e ka popullsinë më të re në Europë dhe se kapitali njerëzor është pasuria më e rëndësishme që do ta mbështes zhvillimin e ardhshëm të Kosovës. Prandaj, hulumtimi është një përbërës i rëndësishëm për mësimdhënie dhe mësim-nxënie cilësore.

## Zbatimi i programeve të doktoraturës

Aktualisht universitetet europiane shfaqin një trend të dukshëm drejt një qasjeje më të strukturuar. Sikur që është vënë në dukje nga EUA në raportin Trendëve 2010 “në nivel të Doktoraturës, dekada e fundit është karakterizuar nga një ekspansion rapid të shkollave doktorale dhe gjithnjë e më shumë vëmendje po i kushtohet mbikëqyrjes dhe trajnimit të doktorantëve”<sup>23</sup>.

Universitetet si i Universiteti i Gracit, Universiteti i Grënadës dhe Universiteti i Vaasa kanë përvetësuar ndërlidhje dhe shkëmbim mes enteve që më parë ishin të ndara. Në fund të fundit, ata synojnë të rrisin dhe të intensifikojnë *potencialin e vet ndërdisiplinor*. Raporti identifikon fushat e studimit të këtyre katër universiteteve, përgjatë të cilave ato organizojnë programet e veta. Me grupimin e ofertës së tyre për studime doktorate ata i nënshtrohen trendit të me sipër përmendur dhe lëvizin drejt një *integrimi të brendshëm edhe më të madh* dhe drejt një *qasje* më të strukturuar. Në përgjithësi mund të vërehet se përgjatë dimensionit të *kohëzgjatjes së studimeve të doktoraturës* që të katër universitetet i përmbahen një konsensusi të zakonshëm të Europës. Kësisoj, Universiteti i Prishtinës pozicionohet në të njëjtën drejtim me rrjedhat Europiane.

Në këtë drejtim, të gjitha universitetet shfaqin një tendencë për *zbatimin dhe betonimin e strategjive institucionale* përmes një plani zhvillimor të miratuar në mënyrë unanime. Universiteti i Prishtinës është krejtësisht në linjë me tendencat e shënuara europiane. Duhet vënë në pah se një këshillim i mirë për Universitetin e Prishtinës do të ishte që të mendonte edhe trendin e rritjes së *bashkëpunimit ndërinstitucional*. Bazuar në zhvillimet aktuale europiane si dhe në shembujt që japin institucionet europiane Universitetit të Prishtinës i rekomandohet që të mundësojë *dialog dhe shkëmbim më të madh ndërdisiplinor*.

Duke krijuar lidhje të rëndësishme dhe duke mundësuar rrugë komunikimi që më parë kanë qenë të mbyllura, ka mundësi të provokohet dhe stimulohet progresi dhe inovacioni shkencor. Çfarëdo mase për të lëvizur në këtë drejtim duhet të mirëpritet dhe inkurajohet.

Elementi më i dukshëm dhe më i rëndësishëm që e karakterizon transformimin e programit doktoral është forma e tij e strukturuar krahasuar me qasjen më të lirshme të disa viteve më parë. Një nga manifestimet e mbetura është e ashtuquajtura *shkolla doktorale*. Sipas kësaj EUA dallon “ndryshimet në studimet e doktoraturës gjatë viteve të fundit: krijimi i strukturave, si shkollat doktorale ose strukturat doktorale/hulumtuuese, me qëllim të sigurimit të një ambienti dinamik të hulumtimit dhe të krijimit të standardeve të besueshme për mbikëqyrje dhe përkrahje”<sup>24</sup>

Analiza tregon se këto tri universitete europiane i përshtatin programet e tyre ashtu që të kenë më shumë *integrim ndër-institucional, shkëmbim ndërdisiplinor dhe strukturim më të madh* të programeve që ata i ofrojnë.

Që tri universitetet i përmbahen me përpikëri asaj që është quajtur zhvendosja e madhe e paradigmës, *ndryshimi i qasjes nga qasja me mësimdhënësin në qendër te ajo me nxënësin në qendër*. Korniza kryesore europiane ofron meta-nivelin respektiv. Ndërgjegjësimi i shtuar për *nevojën e trajnimeve për zhvillimin e aftësive të transferueshme* dëshmon edhe më fort prezencën e këtyre trendeve. Sikur thekson EUA “vërehet se ka një pranim gjithnjë e më të madh të rëndësisë së trajnimeve për zhvillimin e aftësive të transferueshme për të gjithë doktorantët”<sup>25</sup>. Sa i përket Universitetit të Prishtinës kjo dëshmohet me kurikulën e re të “Programi i Doktoraturës në Shkencën dhe Teknologjinë e Ushqimit”, që është zhvilluar në kuadrin e këtij projekti dhe që ndjek këtë qasje të strukturës më të madhe. (p.sh. kreditë nga kurset 60 ECTS, hulumtimi 120 ECTS).

Të tri këto universitete europiane shfaqin një pikë të qartë referimi në raport me *mbikëqyrjen dhe vlerësimin*. Kjo gjë gjithnjë e më shumë merr formën e një marrëveshjeje të mbikëqyrjes, e cila i përcakton qartë të gjitha detyrimet dhe të drejtat e të gjithë aktorëve të përfshirë. Përkundër asaj se moria e rregullave dhe rregullativave ndryshojnë, çdo ku është instaluar një kornizë e përgjithshme. Për sa i përket mësimdhënies dhe mbikëqyrjes, fakti që Universiteti i Prishtinës e ka futur qasjen e bashkë-mësimdhënies së lëndëve dhe seminareve në “Programin e Doktoraturës në Shkencën dhe Teknologjinë e Ushqimit” është mirëpritur me kënaqësi

të madhe. Kësisoj të gjitha lëndët dhe seminarët e ofruara do të mbahen si bashkë-mësimdhënies mes dy profesorësh, një nga Universiteti i Prishtinës dhe një tjetër nga njëri prej universiteteve europiane.

Në rastet kur duhet të promovohet trajnimi ndërdisiplinor dhe trajnimi për zhvillimin e aftësive të transferueshme universitetet europiane pajtohen me ndjesinë e përmendur më sipër për pranimin e rëndësisë së aftësive të transferueshme. Punësueshmëria, ngritja e ndërgjegjësimit për benefitet e mëdha për të theksuar aftësitë e transferueshme në kuadër të kurikulës si dhe udhëzimet e veçanta për *rrugët e mundshme të karrierës dhe planifikimin* e karrierës radhiten në mesin e temave me prioritet në kuadrin e universitetit modern europian.

Që të tri këto universitete europiane promovojnë një shkallë të lartë të ndërkombëtarizimit të shkollimit të tyre doktoral. Raportet e EUA për Trendet flasin se “ndërkombëtarizimi është identifikuar nga ana e arsimit të lartë evropian si ndryshimi i tretë për kah rëndësia, në pesë vitet e fundit dhe pritjet që të zhvendoset në vendin e parë gjatë pesë viteve të ardhshme. Gjithnjë e më shumë institucione po zhvillojnë një *qasje të ndërkombëtarizuar* të mësimdhënies dhe *hulumtimit*”<sup>26</sup> Universiteti i Prishtinës ka nevojë urgjente për bashkëpunim më të madh me universitetet europiane dhe ndërkombëtare. Krahas bashkëpunimit për zhvillimin e programeve apo hulumtimeve të përbashkëta ka nevojë edhe për mbikëqyrjen e përbashkët të disertacioneve të doktoraturave apo për bashkë-ligjërime me profesorët vizitorë. Pastaj, e gjithë kjo mund të rezultojë në organizim të llojeve të përbashkëta të programeve të doktoraturës ku studentët do të mund të përfitonin duke marrë diploma të përbashkëta nga të gjitha universitetet bashkëpunues.

Sa i përket konkurrencës global për të tërhequr studentët dhe hulumtuesit më të mirë bie në sy një tipar i ekzistues: politikat e

promovimit dhe të informimit. Ueb faqet e internetit, si një pikë hyrjeje globale për të gjithë studentët, duhet të jenë transparente, miqësore dhe të kenë informacion të bollshëm (e jo të jenë thjeshtë pasqyrim i strukturave të universitetit). Ato duhet të përmbajnë informata për shkollimin që ofrohet, portofolin institucional, planet dhe strategjinë dhe gjithë këtë duhet ta bëjnë në atë formë që do të jetë e kuptueshme për interesimin e një studenti ndërkombëtar. Veçanërisht është e rëndësishme që të gjitha informatat jetike të jepen në gjuhën angleze; informatat duhet të jetë lehtësisht e kuptueshme dhe të gjendet me lehtësi nëpër ueb faqet: Me një fjalë:sa me shumë që ta ketë studentin në qendër aq me afër ideale është.

Universiteti i Prishtinës për të ardhmen e vet mund të përfitojë duke vrojtuar me kujdes praktikën më të mira që i janë ofruar nga homologët vet europianë. Mund të hartohen struktura të programeve të doktoraturës duke pasur mundësinë të analizohen përvojat e mëparshme, ato që janë provuar dhe testuar më parë në universitetet partnere. Më tutje është me rëndësi të theksohet se përpjekjet ekzistues për *rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal* mes universitetesh duhet të ndiqet fuqishëm ashtu që Universiteti të pozicionohet qëndrueshëm në hartën europiane të arsimit të lartë.

Paragrafi i ardhshëm do të japë një krahasim të shkurtër të tri universiteteve europiane si një lloj përmbledhjeje të fakteve kryesore që u shpjeguan në kapitujt e më sipërm sipas niveleve të ekzaminuara: Profili i Universitetit, Profili i hulumtimit dhe shkollimit doktoral. Mbi këtë bazë kapitulli i ardhshëm do të paraqesë edhe rekomandimet.

The next paragraph will give a short comparison of the three European universities as a summary of the key facts described in the precedent chapters on the examined levels: University Profile, Research Profile and Doctoral Education. Based on this, the next chapter will then present recommendations.



# Rekomandimet dhe si t'i zbatojmë ato në praktikë

Me hartimin e këtij raporti, pas mbledhjes së të gjitha rezultateve dhe konkluzioneve që u nxorën gjatë implementimit të Projektit të TEMPUS "Studimet e doktoratës në shkencën dhe teknologjinë ushqimore dhe ngritja e kapaciteteve për reformë në Universitetin e Prishtinës - PhD@UP", institucionet partnere kanë bërë disa rekomandime që synojnë përmirësimin dhe qëndrueshmërinë. Ajo që ngrit vlerën e këtij kapitulli janë propozimet për mënyrat e zbatimit të këtyre rekomandimeve në praktikë. Përkundër faktit se autoritetet lokale kanë avancuar me disa hapa të rëndësishëm duke siguruar një kornizë strukturale dhe ligjore, është e nevojshme që të bëhen përpjekje me qëllim që të sigurohet një kornizë më e mirë financiare si dhe objektet dhe pajisjet adekuate. Në nivel universiteti, konzorciumi i projektit bën këto tetë rekomandime si në vijim:


## (1) Fuqizoni nivelin strategjik

Rekomandimi që i bëhet Universitetit të Prishtinës me qëllim të plotësimit të veprimeve ekzistuese është: të plotësojë veprimet ekzistuese me një centralizim të brendshëm më të madh dhe me një riorganizim të iniciativave për programet e doktoratës. Raporti aktual tregon se ka një numër tepër të madh iniciativash individuale. Të gjitha këto duhet drejtuar dhe udhëzuar nga një plan zhvillimor për programet e doktoratës i cili duhet të miratohet njëzëri nga të gjitha organet vendimmarrëse si të fakulteteve ashtu edhe të atyre nga universitetit. Kjo gjë mundësohet nga një numër dokumentesh për politikën si dhe nga rregulloret ekzistuese. Megjithatë, organet përgjegjëse vendimmarrëse duhet të sigurojnë zbatimin dhe realizimin e këtyre planeve. Që kjo të bëhet e mundur duhet të ketë një plan efektiv vlerësimi që të garantojë cilësinë e procesit të zbatimit.

Duhet siguruar një balancim të mirë në mes të iniciativave që vijnë nga poshtë me ato që vijnë nga lartë. Iniciativat individuale duhet mirëpritur për aq kohë sa ato i plotësojnë kriteret e cilësisë dhe që përshtaten me Planin e përgjithshëm zhvillimor të universitetit. Raporti vë në pah se ka mungesë të burimeve financiare, veçanërisht të fondeve që mbulojnë shpenzimet e hulumtim-kër-

kimeve. Prandaj, është jashtëzakonisht me rëndësi që të ketë një plan konkret financiar si dhe për të bërë ndarjen e fondeve sipas një plani strategjik të hulumtimit për të financuar kërkimet që lidhen me programet e doktoratës. Nisur nga struktura organizative aktuale e Universitetit të Prishtinës, konzorciumi sugjeron përfshirjen e të gjitha institucioneve të pavarura ligjërisht dhe financiarisht siç janë fakultetet dhe qendrat që ofrojnë arsimimin në nivel doktorate me qëllim që të garantohet zbatimi i suksesshëm. Rrjedhimisht, duhet arritur pajtimin në mes të gjithë përfaqësuesve të të gjitha organeve vendimmarrëse. Për më tepër ata duhet të sigurojnë mbështetjen e plotë për të gjitha masat që ndërmerr menaxhmenti i universitetit.

### Masat dhe aktivitetet:



## (2) Rritni qeverisjen ndër-institucionale


Sipas zhvillimeve europiane aktuale dhe sipas shembujve që japin institucionet europiane, Universitetit të Prishtinës i rekomandohet që të mundësojë dialog dhe shkëmbim më të madh ndërdisiplinor. Progresi shkencor si element inovacioni stimulohet duke krijuar lidhje dhe forma të reja të komunikimit. Ky bashkëpunim ndër-universitar lehtëson shtimin e numrit të studimeve ndërdisiplinore ku përfshihen disa fakultete apo disa departamente. Për më tepër, themelimi i një numri më të madh të grupeve, njësive apo rrjeteve shkencore çon te projekte ndërdisiplinore që do t'i bëjnë bashkë

doktorantët nga fakultete dhe programe doktorale të ndryshme. Mbështetja për këto ekipe të doktorantëve dhe të studentëve të niveleve të tjera të studimit do të krijonte bashkëpunimin dhe punën ekipore dhe do të ofronte shanset për shkëmbimin e përvojave hulumtuuese.

Një nga masat që e mundëson këtë zhvillim është krijimi i shkollave të doktoratës.

Në mënyrë që kjo të mund të përkthehet në praktikë, Universiteti i Prishtinës duhet të marrë në konsideratë kontekstin e strukturës së vet organizative dhe duhet të krijojë struktura të reja që lejojnë bashkëpunim më të mirë ndër-institucional. Sipas planit strategjik të zhvillimit të sipërpërmendur, këtu duhet përfshirë mundësitë e reja të bashkëpunimit mes organeve financiarisht dhe ligjërisht të pavarura sikur janë fakultetet. Në rast nevojë duhet rishikuar planin organizativ të Universitetit të Prishtinës.

### Masat:




## (3) Ndajini fondet sipas planit strategjik dhe shfrytëzoni infrastrukturën në optimum

Raporti aktual tregon se aktualisht ka një mungesë të madhe të pajisjeve dhe hapësirave kërkimore. Prandaj, është nevojë urgjente që infrastruktura ekzistues të optimalizohet në maksimum. Statuti i UP sipas Nenit 58 thotë: "gjatë ndarjes së buxhetit duhet të merren parasysh nevojat e veçanta për obligimet mësimore, kërkimore dhe artistike, të njësive akademike". Prandaj, është e këshillueshme që të përfshihen informacione konkrete për mënyrën e ndarjes së

buxhetit për fushat esenciale të hulumtimit, të identifikuar para-prakisht për programet doktorale të Universitetit, në planin zhvillimor dhe kërkimor të UP. Bashkëpunimi me Ministrinë duhet të jetë i fuqishëm dhe i shpeshtë me qëllim që masat të jenë në linjë me fondet kërkimore dhe zhvillimi i kërkimeve të drejtohet sipas Planit Strategjik Kombëtar. Në këtë kuptim, Universiteti i Prishtinës, si institucioni kryesor i Kosovës që ofron arsim doktorate të bazuar në kërkim, mbështetet nga zbatimi i Planit Strategjik Kombëtar si dhe nga ndarja e fondeve kërkimore.

Universiteti duhet të mbledhë fonde shtesë me synim që: të punësojë personelin për qendrat kërkimore, të sigurojë pajisje dhe hapësira kërkimore si dhe të financojë zhvillimin kërkimor. Investitorët potencialë mund të jenë nga ekonomia, p.sh. kompanitë vendore apo ndërkombëtare që mund të kenë interes për të investuar në kërkimin lokal me qëllim që të bëjnë lokacionin ekonomik të Kosovës më atraktiv. Prandaj, është e këshillueshme që të krijohen partneritete me sektorin lokal. Nëse përdoren fonde shtesë të cilat ndahen për qëllime të financimit të arsimit në nivel doktorate, vetëm për një periudhë të caktuar kohore, duhet përgatitur dhe miratuar një plan të realizueshëm dhe të qëndrueshëm përpara se programi të nisë. Këtu përfshihet planifikimi i të gjitha masave të ndërmarra në planin organizativ dhe financiar, pasi që të shpenzohen fondet e marra nga jashtë. Kjo me qëllim që të sigurohet vazhdimësia e programeve respektive.

### Masat dhe aktivitetet:




## (4) Rritni kapacitetet përmes bashkëpunimit (ndërkombëtar)

Përkundër faktit se Universiteti i Prishtinës tashmë merr pjesë në aktivitete, projekte dhe iniciativa të ndryshme me qëllim të rritjes së mundësive për të ofruar një arsim të nivelit ndërkombëtar, sikundër

që edhe përfiton nga të gjitha këto, megjithatë i rekomandohet që edhe më tutje të rrisë bashkëpunimin ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal në kudër të programeve të doktoraturës. Këto projekte nuk duhet përdorur vetëm për të rritur lidhjet ekzistuese dhe për të krijuar lidhje të reja, por gjithashtu edhe për të krijuar kapacitete të reja përmes ofertës për programe të përbashkëta të studimeve doktorale, për kurse të mbajtura nga profesorë vizitorë nga jashtë vendit, për sigurimin e pajisjeve adekuate, pastaj, duke ofruar instruksione dhe duke përdorur teknologjinë dhe laboratorët përkatës si dhe me qëndrimet kërkimore në njërin nga institucionet partnere. Për më tepër, programet e përbashkëta të studimeve të doktoratës janë një mundësi për të ofruar arsim me cilësi të lartë në nivelin e doktoratës. Është e këshillueshme që të krijohen lidhje më të mira për këto lloje bashkëpunimi me qëllim që të nxirren përfitime nga përvojat e shkëmbyera, të përjashtohen mundësitë e ripërsëritjes së aktiviteteve dhe të nxirren përfitime nga efektet sinergjike nga koncantrimi i burimeve dhe shkathtësive. Përveç kësaj, UP gjithashtu duhet që të fokusohet në mobilitetet ndërkombëtare brenda kornizës së programeve të doktoraturës dhe bashkëpunimit ndër-institucional; ashtu që kandidatët të mund të paraqesin kërkesa për të fituar grante të mobiliteteve me qëllim që të marrin pjesë nëpër konferenca apo shkolla verore.


**Measures**



**(5) Zvogëlojini numrin e programeve të doktoratës – grupim i programeve në shkolla më të mëdha**

Institucionet partnere të këtij projekti kanë vërejtur se Universiteti i Prishtinës ka zbatuar programe të reja të doktoratës dhe ka ndërruar një pjesë të programeve të vjetra por nuk i ka përfshirë programet e doktoratës (paraprake) në një apo dy programe të reja me mundësinë për disa linja të kërkimeve dhe specializimeve sikur i kanë institucionet partnere europiane të këtij projekti të TEMPUS. Kësisoj, ka një ripërsëritje të programeve të ndryshme. Është e këshillueshme që të krijohen programe doktorale që kapin një rreze më të gjerë se sa një program i vetëm kualifikimi. Kjo gjë jo vetëm që krijon një perspektive më të madhe ndërdisiplinore por gjithashtu lejon një përfshirje më të madhe të studentëve potencialë. Për veç kësaj, kjo çon drejt një kornize më të thjeshtëzuar të organizimit. Në universitetet europiane, është dëshmuar një rritje e shpejtë e shkollave të doktoraturës. Duke bërë grupimin e ofertës për studime të doktoratës ato rrisin integritetin e brendshëm dhe krijojnë një qasje më të strukturuar.

**Masat:**



**(6) Zbatoni arsimin e bazuar në hulumtim/kërkim**

Për t'u zbatuar arsimi i bazuar në hulumtim duhet të rritet kapaciteti hulumtues i universitetit. Të gjitha programet doktorale duhet të jenë të bazuara në hulumtime, me një numër të vogël aktiviteteve akademike, të cilat kanë për qëllim komplementimin e hulumtimeve dhe aftësive profesionale. Kandidatët për doktoraturë nuk duhet të shihen si studentë por si hulumtues të rinj dhe duhet të përkrahen si të tillë.


Kualiteti i hulumtimit dhe rëndësia e tij për transformimin e diturisë dhe inovacionit duhet të jenë në qendër të arsimit doktoral për t'u bërë faktor i progresit ekonomik dhe shoqëror. Prandaj duhet të inkurajohet hulumtimi origjinal.

Të tri universitetet partnere europiane i përmbahen në mënyrë strikte të ashtuquajturës ndërrim të paradigmes, ndryshimit nga një qasje e fokusuar në mësimdhënie në një të fokusuar në mësimnxënie, e cila duhet të jetë shembull edhe për Universitetin e Prishtinës. Një strukturë gjithpërfshirëse europiane e siguron niveli Meta.

Programet e nivelit të doktoraturës duhet të përfshijnë gjithashtu ligjëratat dhe seminare mbi aftësitë e transferueshme, të cilat janë të rëndësishme për kompetencat profesionale si menaxhimi i projekteve, lidhshipi, komunikimi dhe puna në grup. Arritja apo njohja e këtyre aftësive mund t'i përmirësojë perspektivat e të diplomuarve dhe si rrjedhojë mund të paraqesë element esencial përbrenda misionit të cilitdo institucion arsimor.

Themelimi i një plani personal të zhvillimit për secilin kandidat individualisht do t'i ndihmonte kandidatët të njohin dhe artikulojnë aftësitë dhe kompetencat, të cilat i marrin përgjatë përfundimit të studimeve. Për më tepër, plani specifikon orarin e trajnimit si për aftësi shkencore ashtu edhe për të përgjithshme, varësisht nga nevojat kritike të secilit kandidat


**Masat:**



**(7) Lidhni programet doktorale me tregun**

Aktualisht, shumica e programeve doktorale ne Universitetin e Prishtinës kanë një qëllim kryesor arsimor, përkatësisht trajnimin e studentëve për t'u bërë ligjërues universiteti. Për t'i lidhur programet doktorale me tregun është e rëndësishme të përfshihet edhe sektori privat, deri në një masë, në dizajnimin dhe zbatimin e studimeve Programet doktorale dhe kurrikulat e tyre duhet të lidhen me shoqërinë, ekonominë dhe tregun e punës. Për ta garantuar këtë, kurrikula duhet ta përfshijë një seksion mbi profilin e kualifikimit të të diplomuarve dhe mbi lidhjen mes aftësive të ofruara nga programi dhe kërkesat e tregut të punës. Punësueshmëria, rritja e ndërgjegjësimit për benefitet enorme të theksimit të aftësive të transferueshme në kurrikulat e programeve doktorale dhe udhëzime specifike mbi drejtimin e karrierës dhe planifikimin e saj janë ndër prioritetet kryesore në universitetet moderne europiane. Për të lehtësuar një bashkëpunim më të fortë me partnerë të jashtëm si industria dhe kompanitë ose për të rikthyer bashkëpunimin me grupet e interesit, Universiteti i Prishtinës udhëzohet të organizojë evenimente për të ngritur vetëdijen për karrierën

**Masat**



**(8) Vështrojini për së afërmi praktikat më të mira që u japin homologët europianë**

Strukturat e ardhshme doktorale mund të modelohen mbi bazat e asaj që tashmë është testuar dhe provuar nëpër universitetet partnere. Gjithashtu është me rëndësi të theksohet se përpjekjet ekzistuese për të shtuar bashkëpunimin ndërkombëtar duhet të vazhdojë me intensitet të shtuar me qëllim që të pozicionojë universitetin fuqishëm në hartën e arsimit të lartë europian dhe global.

# Autorët

**Prof. Dr. habil. Bajram Berisha**, Prof. Dr. Habil. Bajram Berisha, (lindur në Suharekë, Republika e Kosovës). I diplomuar në Universitetin e Prishtinës (UP), Kosovë (BSc., 1986), Universitetin e Lubjanës (MSc., 1992) dhe Universitetin Teknik të Munihut (TUM), Gjermani (PhD, 2001 dhe habilitim, 2007). Ai është shkencëtar me një përvojë të gjatë në fushën e fiziologjisë së shtazëve, gjenetikë dhe bio-teknologji si dhe autor i shumë artikujve origjinalë kërkimor-shkencor dhe publikimeve të tjera botuar në revistat më të mira të fushës dhe faktor të lartë impakti. Hulumtimi i tij fokusohet në veprimin e faktorëve angiogjenikë dhe limfangiogjenik në vezorët e gjedhit gjatë fazave të ndryshme fiziologjike. Është i emëruar Privatdozent në TUM (2007), Profesor i angazhuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës – AUT (2011) dhe Profesor i Rregullt në Universitetin e Prishtinës (2010). Gjatë verës 2013-2014, z. Berisha qëndroi si Profesor Vizitor në TUM, (Departamenti i Fiziologjisë, Weihenstephan. Ai ishte Prorektor për Çështje Mësimore në Universitetin e Prishtinës (2009-2012), Kryetar i Këshillit Shkencor në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Qeveria e Kosovës, (1010-2011) anëtar i Këshillit Kombëtar të Cilësisë në Agjencinë Kosovare të Akreditimit (AKA), MASHT (2007-2008). Që nga 2009 ai është anëtar i Qendrës Informativë për Njohje Akademike (QINJA), MASHT dhe anëtar i Ekipit Kombëtar të Profesionistëve për Reformën e Arsimit të Lartë (EKPRAL), Komisioni European. Prof. Berisha ishte pjesë e shumë projekteve të TEMPUS në UP, TUM, AUT, dhe nga viti 2010 ai është koordinator lokal i projektit të TEMPUS: “Programi i Doktoraturës në Shkencën dhe Teknologjinë e Ushqimit dhe Ngritja e Kapaciteteve për Reformën e Programeve të Doktoraturës në Universitetin e Prishtinës/Kosovë PhD@UP), për të cilin grant mbajtës është Universiteti i Gracit ndërsa Universiteti i Prishtinës është institucioni kryesor përfitues.



**Dr. Petri Helo** është Profesor në Menaxhmentin Industrial, Sistemet Logjistike dhe është kryetar i grupit hulumtues Sistemet e Vlerës së Rrjetëzimit (Networked Value Systems), në Universitetin e Vaasa, Finlandë. Hulumtimi i tij trajton menaxhimin e sistemeve të logjistikës në rrjetën e kërkesës dhe ofertës dhe përdorimin e veprimtarisë së IT. Dr. Helo gjithashtu është partner dhe anëtar i bordit në Wapice Ltd. provider për zgjidhje softuerike në konfigurim të sistemeve të shitjeve dhe përshtatjes ndaj masës konsumuese.



**Hysen Bytyqi**, Dr. Profesor i Asocuar në Shkencën e ushqimit të kafshëve në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës. Deri tani ka publikuar 19 punime shkencore në revista me renome dhe 28 publikime në kongrese, simpoziume dhe seminare, dy libra profesionalë dhe 1 kapitull të një libri tjetër. Ai ka kryer më shumë se 10 hulumtime dhe projekte kombëtare e ndërkombëtare. Aktualisht, është drejtor i Zyrës për Zhvillim Akademik dhe kryetar i njësisë për zhvillim të Universitetit të Prishtinës.



**Anja Hoffmann**, e diplomuar në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Magdeburg-Stendal (Gjermani) për Përkthim Teknik në Gjermanisht, Spanjisht dhe Rusisht dhe ka titullin Doktor Shkence nga Universiteti i Grënadës (Spanjë) për Studime në Përkthimologji, që nga tetori i vitit 2012 është punonjëse e Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Gracit. Kariera e saj profesionale në zonën e bashkëpunimit ndërkombëtar ka nisur me 2006 në Zyrën për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Universitetit të Grënadës. Ajo ka qenë shefe e departamentit për Informim Dokumentim dhe Marketing gjatë viteve 2009-2010 dhe është bërë shefe e departamentit për Mobilitete në vitin 2010, prej ku koordinon disa programe arsimore siç janë LLP/Erasmus, Erasmus Mundus Action 1 dhe 2, Studime të përbashkëta, Kurset Verore, programi për Asistencë të Mësimdhënies së Gjuhëve të Huaja, Periudhat e Trajnimeve, EU-US Atlantis, PIMA, Coimbra Group, Fundacion Carolina, Free Mover dhe IES Abroad për studentë dhe stafin vizitorë si për ata që vijnë ashtu edhe për ata që shkojnë jashtë vendit. Në Universitetin e Gracit ajo ishte përgjegjëse për detyrat administrative të të gjitha programeve të Diplomave të Përbashkëta pastaj në mars 2014, u zhvendos te departamenti i Mobilitetit të Studentëve..



**Ulrich Hörmann** është shefi i financave në OeAD që nga viti 2009. Ai ka më tepër se 20 vite përvojë substanciale në fushën e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë dhe të projekteve të përbashkëta. Ka shërbyer si Sekretar i Përgjithshëm i Shërbimi i Shkëmbimit të Përgjithshëm Austriak (Austrian Exchange Services) (ÖAD, një shoqatë e universiteteve austriake) nga viti 2000 deri 2008, pasi kishte shërbyer 10 vite në të njëjtën oranzatë së pari si Shef i Departamentit të Zhvillimit dhe Bashkëpunimit dhe pastaj si Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm. Ulrich Hörmann ka studiuar shkencat shoqërore dhe ekonomike si dhe teologjinë katolike. Ka specializuar me temën e Masterit në çështje të barrierave të tregut pa tarifa në mes SHBA, Europes dhe Japonisë.



**Ulrike Krawagna**, e diplomuar në Universitetin e Gracit për Histori dhe Studime Franceze, është punonjëse e Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Gracit që nga viti 2001. Në fazën e zbatimit të Procesit të Bolonjës, ajo ka vepruar si Promotore e Bolonjës (2003-2007) dhe ka lëvizur në mes mësimdhënies dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Gracit ku është marrë me zhvillimin e kurikulës, zbatimin e ECTS dhe suplementit të diplomës etj. Pastaj i është bashkuar grupit të projektit për zbatimin e Diplomave të Përbashkëta, që nga 2007 ajo e ka menaxhuar këtë projekt. Në vitet 2007 – 2012 ishte koordinatorë e disa projekteve të TEMPUS sic janë JoinSee (Shembull i Ekselencës për Menaxhimin e Diplomave të përbashkëta në Europën Jug-lindore), PhD@UP dhe INTERFACE si dhe Erasmus Mundus Action 2 sic janë projektet JoinEUSee I-IV. Tani është përgjegjëse për menaxhimin e 14 programeve të Diplomave të Përbashkëta që i ofron Universiteti i Gracit.



**Gerald Lind** ka studiuar historinë dhe gjuhën dhe letërsinë gjermane në Universitetin e Vjenës në Universitetin e Edinburgut. Nga viti 2006 deri në 2009 Lind ishte anëtar i grupit doktorat “Kulturën e Ndryshimit” në Universitetin e Vjenës. Pasi ka përfunduar studimet e doktoraturës Lind ka punuar si ligjërues për historinë dhe teorinë e kulturës dhe letërsisë në institucione të arsimit të lartë në Austri. Që nga shtatori i vitit 2011 Lind është bashkëpërgjegjës për qendrën e shërbimit të studimeve doktorate DocServices në Universitetin e Gracit. Lind ka publikuar një monografi, është bashkë-redaktor i dy antologjive, autor i disa artikujve për letërsinë austriake dhe për teorinë e kulturës dhe autor i më shumë se 35 recensioneve të librave të ndryshëm. Meta-romani i tij “Zerstörung” (“Shkatërrimi”)u botua në maj 2013 bashkë me Neofelis –Verlag qe e ka bazën në Berlin. Ai ka ndihmuar prezantimet apo ka drejtuar uorkshopet në fushën e studimeve letrare dhe të studimeve doktorale në Finlandë, Sllovaki, Slloveni, Kroaci, Hungari, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë.



*Prof. Dr. Michael W. Pfaffl* me 1986 nisi të studiojë “Bujqësinë” me theks te “Shkencat e Kafshëve” në Universitetin Teknik të Munihut (TUM). Ai e mori diplomën e dytë universitare në TUM në “Bioteknologji” paralelisht me studimet e tij të doktoraturës.



Me 1997 ai e mori doktoraturën e tij “Fiziologjinë Molekulare” në fushën e fiziologjisë molekulare e rritje dhe muskujve në TUM, Departamenti i Fiziologjisë (Dr. agrar).

Në qershor 2003 ai ka kryer Habilitimin e tij (Dr. habil) në Qendrën Shkencave Jetësore dhe të Ushqimit në Weihenstephan me titullin “Transkriptoma e bagëtisë: analizi kuantitativ i mRNA-së në endokrinologjinë molekulare dhe fiziologjia e gjëndrës qumështore”.

Me 2010 ai mer titullin Profesor i Fiziologjisë Molekulare në Universitetin Teknik të Mynihut në Freising. Sot ai mban titullin “Hulumtues Kryesor” (Principal Investigator) si drejtor i Institutit të Fiziologjisë. Është një ndër shkencëtarët liderë në teknologjinë e qPCR, kuantifikimin relativ të mRNA-së dhe profilizimin e ekspresionit të ARN-së së shkurtër. Ai është autor i rreth 140 publikimeve të shqyrtuara nga kolegët, 40 kapituj librash dhe 190 ligjëratash në mbarë botën. Në mars 2012 Prof. Michael W. Pfaffl iu dha Cmimi SciVerse Scopus 2012, artikulli i tij më i cituar në Scopus është ai me titullin “Një model i ri matematik për kuantifikimin relativ në kohë reale RT-PCR” i botuar me 2001 në Nucleic Acids u citua më shumë se 8000 herë në Scopus (më 2014 më shumë se 12500 herë).

Është bashkautor i udhëzimeve të Informatat minimale për publikimin e eksperimenteve me metodën PCR në kohë reale (MIQE) (2009) dhe bashkautor për udhëzimet e MIQE për PCR-in digjital (2013).

*Prof. Antonio Sánchez Pozo, PhD in Pharmacy*, PhD in Pharmacy, profesor i rregullt i Biokimikës, Universiteti i Granadës, është konsulent i Agjencisë Spanjolle të Medikamenteve, Ministria e Spanjolle e Shëndetit (programi FIS), Ministrisë Spanjolle të Arsimit për cilësi në universitete, Agjencisë Spanjolle të Cilësisë (ANECA), Njësisë Aandaluzia-



ne për Cilësisë (UCUA) si dhe Agjencisë për Vlerësimin e Cilesisë dhe Akreditimit të Sistemit universitar të Baskisë (UNIBASQ). Gjithashtu është edhe konsulent i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve të Republikës Ceke, i Task Forcës për Trajtime dhe Mobilitet i Grupit Coimbra të Universiteteve, i Qendrës për Arsimin e Lartë Ndërkombëtar të Kolegjit të Bostonit, i Agjencisë Kosovare të Akreditimit, Këshillit Irlandez të Hulumtimit dhe Bordit për Studime dhe Hulumtime të Avancuara, Universiteti i Karacit (Pakistan). Ka qenë prodekan për Çështje Akademike dhe Plane Studimi në Fakultetin e Farmacisë, nëndrejtor i Shkollës për Analizë Klinike, Drejtor i Programeve Inovative dhe Cilësore, Komisionar Prorektor për Zonë Europiane të Arsimit të Lartë, Prorektor për Mësimdhënie, Planifikim dhe Inovacion në Universitetin e Grënadës si dhe Drejtor Gjeneral i Universiteteve të Qeverisë së Andaluzisë, Spanjë.

*Ines Suh*, me origjinë nga Bosnja dhe Hercegovina, është Menaxhere e Projektit në organizatën jo-qeveritare Shërbimet Botërore Universitare (WUS) Austria. Ajo ka gjashtë vite përvojë pune të koordinimit të projekteve dhe fokusi i saj është në zhvillimin e kurikulës sipas standardeve të Bolonjës si dhe në krijimin e lidhjeve mes shkollimit të lartë dhe ekonomisë. Aktualisht ajo menaxhon projektet me fokus në zhvillimin e kurikulës, përmirësimin e strukturës dhe proceseve të Programeve të Doktoraturës si dhe mësim-nxënien e bazuar në kompetenca. Ajo ka përvojë në zhvillimin e projekteve, raportimin te donatorët, monitorimin e financave të projektit. Ka diplomë të dyfishtë Masteri për Administrim Biznesi nga Universiteti i Gracit dhe është doktorante në të njëjtin institucion.



1: Bashkësia Europiane [http://europa.eu/legislation\\_summaries/education\\_training\\_youth/lifelong\\_learning/c11088\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/education_training_youth/lifelong_learning/c11088_en.htm)

2: Marrëveshja e performancës, p.23, Universiteti i Gracit

3: Udhëzimet e Director of Studies për themelimin dhe zbatimin e programeve të doktoraturës në Universitetin e Gracit.

4: Udhëzimet e Director of Studies për themelimin dhe zbatimin e programeve të doktoraturës në Universitetin e Gracit, të shpallura në Mitteilungsblattform 29 prill 2009.

5: Modificación de las Normas Reguladoras de las Enseñanzas Oficiales de Doctorado y del Título de Doctor por la Universidad de Granada (aprobadas en la sesión ordinaria del Consejo de Gobierno de 30 de octubre de 2013, p. 6)

6: Modificación de las Normas Reguladoras de las Enseñanzas Oficiales de Doctorado y del Título de Doctor por la Universidad de Granada (aprobadas en la sesión ordinaria del Consejo de Gobierno de 30 de octubre de 2013, p. 6)

7: Informacioni mund të gjendet në ueb faqet e Universitetit: <http://www.uva.fi/>

8: Rregullore për Studimet Doktoraturës - Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 1

9: Rregullore për Studimet Doktoraturës - Universiteti i Prishtinës, 2013, fq. 2

10: Marrëveshja e Performancës 2010-2012 e Universitetit të Gracit me Ministrinë Austriake Federale të Shkencës

11: Udhëzimet e Director of Studies për themelimin dhe zbatimin e programeve të doktoraturës në Universitetin e Gracit.

12: Neni 4 i Rregullores për Studime të Doktoraturës – Universiteti i Prishtinës.

13: Republika e Kosovës, Këshilli Kombëtar i Hulumtimit, Programi Kombëtar i Hulumtimit i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2010, fq. 10

14: Instituti Hulumtues i Zhvillimit dhe Ceshtjeve Europiane (Ridea), Gjendja e Hulumtimit në Kosovë. Korporate Austriake e Zhvillimit 2012. Fq.10

15: Instituti Hulumtues i Zhvillimit dhe Ceshtjeve Europiane (Ridea), Gjendja e Hulumtimit në Kosovë. Korporate Austriake e Zhvillimit 2012. Fq.12

16: Instituti Hulumtues i Zhvillimit dhe Ceshtjeve Europiane (Ridea), Gjendja e Hulumtimit në Kosovë. Korporate Austriake e Zhvillimit 2012. Fq.9

17: Komisionin Europian: Raporti Analitik për Kosovën @Q12, fq. 42

18: Instituti Hulumtues i Zhvillimit dhe Ceshtjeve Europiane (Ridea), Gjendja e Hulumtimit në Kosovë. Korporate Austriake e Zhvillimit 2012. Fq.15

19: Këshilli Kombëtar i Hulumtimit: Programi Kombëtar Strategjik i Hulumtimit i Republikës së Kosovës, fq 10

20: Gr. Teknopolis: Studimi për organizimin e programeve të Doktoraturës në vendet fqinje të BE. Kosova nën Rezolutën 1244/99 UNSCR fq 10

21: Gr.Teknopolis: Studimi për organizimin e programeve të Doktoraturës në vendet fqinje të BE. Kosova nën Rezolutën 1244/99 të UNSCR fq 10

22: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, fq 10

23: Trendet e EUA 2010, fq 7

24: Trendet e EUA 2010, fq 43

25: Trendet e EUA 2010, fq 44

26: Trendet e EUA 2010, fq 8

## Referencat dhe ueb faqet

Universiteti i Prishtinës, Rregullore për Studimet e Doktoraturës 2013

Republika e Kosovës, Statuti i Universitetit të Prishtinës: <http://www.uni-pr.edu/Files/Dokumente/Relevante/Statutiversioniifundit.aspx> (qershor 2014)

Universiteti i Gracit, Marrëveshja e Performancës: [https://online.uni-graz.at/kfu\\_online/wbMitteilungsblaetter.display?pNr=159512](https://online.uni-graz.at/kfu_online/wbMitteilungsblaetter.display?pNr=159512) (qershor 2014)

Universiteti i Gracit, udhëzimet e Director of Studies për themelimin dhe zbatimin e programeve të doktoraturës

Universidad de Granada, Modificación de las Normas Reguladoras de las Enseñanzas Oficiales de Doctorado y del Título de Doctor por la Universidad de Granada (aprobadas en la sesión ordinaria del Consejo de Gobierno de 30 de octubre de 2013)

Universiteti i Vaasa, Statuti i gradave postdiplomike që mund të gjendet në Ligjin për Universitete Act 558/2009, Vendimi qeveritar për Gradat Universitare 794/2004 dhe Urdheri për grada i Universitetit të Vaasa (i pranuar me 9 mars 2012) [http://www.uva.fi/en/research/researcher/graduate\\_school/postgraduate\\_studies](http://www.uva.fi/en/research/researcher/graduate_school/postgraduate_studies) (qershor 2014)

Instituti Hulumtues i Zhvillimit dhe Cështjeve Europiane (Ridea), Gjendja e Hulumtimit në Kosovë. Austrian Development Cooperation 2012

Komisioni Europian, Raporti Analitik i Kosovës 2012, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2012/package/ks\\_analytical\\_2012\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf) (qershor 2014)

Këshilli Kombëtar i Hulumtimit: Programi Kombëtar i Hulumtimit i Republikës së Kosovës (Prishtinë 2014)

Grupi Teknopolis, Studimi për organizimin e programeve të doktoraturave në vendet fqinje të BE. Kosova nën rezolutën e UNSCR 1244/99 (2010)

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë: Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011 -2016

Asociacioni i Universiteteve Europiane (EUA), Programet Doktorale për Shoqërinë Europiane të Dijes. Raporti për Programet doktorate të EUA Projekti 2004 -2005 [http://www.eua.be/eua/jsp/en/upload/Doctoral\\_Programmes\\_Project\\_report.1129278878120.pdf](http://www.eua.be/eua/jsp/en/upload/Doctoral_Programmes_Project_report.1129278878120.pdf)

Asociacioni i Universiteteve Europiane (EUA), Programet Doktorale në Universitetet Europiane: Të Arriturat dhe Sfidat. Raporti i përdorur për universitetet europiane dhe Ministrat e Arsimit të Lartë (Bruksel 2007) [http://www.eua.be/fileadmin/user\\_upload/files/Publications/Doctoral\\_Programmes\\_in\\_europe\\_s\\_universities.pdf](http://www.eua.be/fileadmin/user_upload/files/Publications/Doctoral_Programmes_in_europe_s_universities.pdf)

Asociacioni i Universiteteve Europiane (EUA), Trendet 2010: një Dekadë e Ndyshimeve në Arsimin e Lartë Europian nga Andrée Sursock & Hanne Smidt (Bruksel 2010), [http://www.eua.be/Libraries/Publications\\_homepage\\_list/Trends2010.sflb.ashx](http://www.eua.be/Libraries/Publications_homepage_list/Trends2010.sflb.ashx)

Asociacioni i Universiteteve Europiane (EUA), Këshilli i Arsimit Doktorat, të gjithë dokumentet mund të gjenden në: <http://www.eua.be/cde/Home.aspx>

Procesi i Bolonjës, të gjithë dokumentet mund të gjenden në: [http://europa.eu/legislation\\_summaries/education\\_training\\_youth/lifelong\\_learning/c11088\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/education_training_youth/lifelong_learning/c11088_en.htm) (qershor 2014)